



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2017**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. DECEMBRA 2017. GODINE**

**DHJEOR - DECEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova za 2018

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të fillojmë me pikën e rendit të ditës, ju njoftoj se me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me zëvendësimin e deputetit Agim Aliu nga koalicioni PAN, me deputetin Muharrem Nitaj, nga i njëjti subjekt politik.

Betimi i deputetit është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit, për të përmbushur këtë detyrim lus deputetin që të ngritet në këmbë, ta dëgjojë tekstin që do të lexoj unë dhe vetëm në fund ta shqiptojë fjalën “betohem”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem”!

MUHARREM NITAJ: Betohem!

KRYETARI: Deputetit të ri i dëshirojmë mirëseardhje dhe e ftoj që ta nënshkruajë tekstin e betimit, pastaj administrata do ta marrë nga ju, vjen në vend. Faleminderit, mirë se ke ardhur!

Ndërkohë para se të fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës, shefi i Grupit Parlamentar, zoti Avdullah Hoti, ka kërkuar të lexojë një mocion përmbajtjesor. Urdhëro, i nderuar Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Gjatë dy ditëve të fundit kemi dëgjuar deklarime jashtë çdo etike njerëzore për të vrarët pas luftës, zyrtarë të lartë të LDK-së, prandaj grupi ynë parlamentar, pas diskutimeve që ka pasur dje edhe në Kryesinë e Kuvendit, ku ka pasur një mirëkuptim për këtë veprim të LDK-së, dëshiron që sot të lexojë mocionin përmbajtjesor dhe kërkon nga të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët që të mbështesin këtë mocion përmbajtjesor. Më lejoni ta lexoj këtë:

M o c i o n

“Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon gjuhën fyese dhe të urrejtjes të përdorur nga përfaqësuesi i Organizatave të Veteranëve të Luftës së UÇK-së për vrasjet politike të veprimtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga institucionet e drejtësisë që urgjentisht të ndërmerren të gjitha masat adekuate që vrasjet politike të veprimtarëve të LDK-së të trajtohen me seriozitet, me profesionalizëm dhe paanshmëri dhe të marrin dënimin e merituar.

Vetëm zbulimi i vrasjeve politike dhe i të gjitha krimeve të tjera të pandriçuarat garanton zhvillimin e Kosovës si shtet, ku sundon ligji dhe e drejta dhe ku të gjithë qytetarët, pa dallim, ndihen të sigurt”.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe kërkoj nga Kuvendi që ta mbështesë këtë mocion përmbajtjesor. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Kemi një mocion përmbajtjesor, në bazë të Rregullores, është seancë e jashtëzakonshme.

Megjithatë unë po ua lë kryetarëve të grupeve parlamentare që të deklarohen për mocionin, që pastaj të procedojmë.

Glauk Konjufca nga “Vetëvendosja”, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ky është qëndrimi i LDK-së, nuk ka nevojë, Memli Krasniqi, grupet parlamentare, urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Po, ne mendojmë që gjuha e përdorur nga përfaqësuesi i shoqatave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj, lidhur me vrasjen e shumë personaliteteve pas luftës, të cilët kanë qenë edhe, të themi, aktivistë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është një gjuhë e papranueshme, është në të njëjtën kohë e dënueshme dhe e cila nuk duhet të zërë vend në Republikën e Kosovës, jo vetëm nga përfaqësuesit e lartë të institucioneve të ndryshme, qoftë edhe të shoqatave, por as nga qytetarët e zakonshëm të Republikës së Kosovës.

Pra, ne mendojmë që do të ishte mirë që të përkrahet një mocion i tillë, që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta thotë fjalën e vet lidhur me paraqitjen e qëndrimit që një fjalor i tillë të jetë i papranueshëm dhe që, do të ishte mirë edhe vetë zotëria që e ka përdorur një fjalor të tillë, të dalë në media të kërkojë falje, jo vetëm për qytetarët e Kosovës, por para se të gjithash për familjet e të ndjerëve, të cilët nuk po mund të gjejnë qetësi, ngase nuk ka pasur drejtësi në Kosovë për këto raste që prej vitit 1999.

Më e pakta që do të mund të bënim ne është ky mocion, mirëpo vetë zoti Haradinaj do të ishte mirë të dilte dhe të tërhiqte një fjalë të tillë, një mendim të tillë, të kërkonte falje dhe kjo do të ishte më e pakta që do të mund të ndodhte.

KRYETARI: Memli Krasniqi, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, le të përgatitet Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ne e diskutuam edhe dje në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit këtë çështje dhe patëm konsensus, një pajtueshmëri të plotë nga të gjithë përfaqësuesit se gjuha e tillë është e papranueshme, e dënueshme dhe, si e tillë, meriton të thuhet fjala dhe qëndrimi nga të gjitha institucionet, gjë që është bërë edhe dje dhe ju vetë, zoti kryetar, jeni deklaruar, edhe presidenti, dhe po ashtu kryeministri dhe mendojmë se ne duhet ta mbështesim unanimitisht mocionin përmbajtjesor të prezantuar nga shefi i Grupit të LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkon që organet e drejtësisë të zbulojnë të gjitha vrasjet që kanë ndodhur pas luftës në Kosovë.

Prandaj, ky është qëndrimi ynë, organet e drejtësisë duhet ta luajnë rolin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, Bilall Sherifi, pastaj “6+”.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, kolegë deputetë,

Zoti kryetari i Kuvendit,

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë nuk do të kisha pasur më shumë t’i shtoj asaj që u tha edhe dje në mbledhjen e Kryesisë dhe atë që ju në emër të Kryesisë e thatë dje në konferencë për shtyp.

Vazhdojmë të mendojmë se duhet të kemi kujdes, sidomos kur përfaqësojmë organe, forume, institucione të rëndësishme që mendimet tona t’i përmbledhim mirë, sepse fjalët që thuhet një

herë, pastaj nuk mund të tërhiqen, edhe nëse qëllimi nuk ka qenë i tillë. Shpeshherë themi gjënë e gabuar në mënyrë të duhur, por edhe gjërat që i mendojmë ndryshe, mund t'i themi në mënyrë të gabuar.

Prandaj, është mirë të gjithë që mbajnë një përgjegjësi politike dhe publike, para se të flasin të jenë të përmbledhur në mendimet e tyre.

Ne vazhdojmë të jemi në një linjë po ashtu me partnerët e koalicionit dhe me opozitën që të kontribuojmë në atë që quhet 'rend dhe ligj'. Pra, të mos marrim drejtësinë në dorë as për të gjykuar, por as për të marrë në mbrojtje askënd.

Unë bashkëndiej me familjarët e atyre që kanë humbur njerëzit, të cilët u apostrofuan, por gjithashtu bëj apel që askush të mos tentojë apo të mos provojë tani të nxjerrë kapital nga asnjë palë lidhur me këto. Drejtësia le të vazhdojë me ngulm edhe më të madh, duhet të vazhdojë t'i ndriçojë të gjitha vrasjet që kanë ndodhur, sidomos ato pas luftës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albert Kinolli, nga "6+", Lista serbe, ju lutem, dikush le të lajmërohet, kush flet në emër të Listës serbe?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,
I nderuar kryeministër, zoti Haradinaj,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Pas gjithë atyre deklarimeve që thanë kolegët e mi të nderuar, shefat e grupeve parlamentare dhe pas gjithë atij diskutimi të mbrëmshëm në mbledhjen e Kryesisë, mua nuk më mbetet asgjë tjetër të them veçse t'u bashkëngjitem kolegëve të mi të nderuar dhe po ashtu vlen të ceket se Grupi Parlamentar "6+" e përkrah mocionin, i cili vjen nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lista Serbe, a ka të lajmëruar? Nuk ka.

Kërkoj nga administrata që t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës mocioni, pastaj ndërkohë, kur të kryhet procedura e shpërndarjes, shkojmë në votim. Ne vazhdojmë ndërkohë me seancën plenare, me pikën e rendit të ditës, të cilën e kemi. I lutem administratës ta shpërndajë.

Aktualisht jemi 101 deputetë.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime të komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Gjatë javës së shkuar Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nëpërmjet ndarjes së punës në dy grupe punuese.

Në njërin grup janë trajtuar kërkesat e agjencive të pavarura dhe ministrive të Qeverisë së Kosovës.

Në grupit tjetër janë trajtuar kërkesat e komunave të Kosovës, amendamentet e deputetëve, janë trajtuar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Të dy grupet punuese kanë mbajtur takime, dëgjime publike me parashtruesit e kërkesave, grupet janë munduar të dresojnë konform kufizimeve buxhetore pjesën më të madhe të kërkesave. Me theks të veçantë, të atyre ideve që promovojnë jetën e qytetarëve që ndikojnë në zhvillim ekonomik të vendit.

Komisioni ka shqyrtuar plot 102 amendamente, të propozuar nga deputetët, komisionet dhe grupet parlamentare.

Pas përfundimit të punës në konsultim me Ministrinë e Financave, komisioni ka propozuar 140 ndryshime në draft-buxhet.

Ndryshimet e propozuara shërbejnë për atë që ka kompetencë komisioni në eliminimin e defekteve, lëshimeve eventuale në buxhet, në adresimin e kërkesave të domosdoshme për vendin.

Ne kemi trajtuar dhe përkrahur ide e projekte, me theks të veçantë në fushën e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit nëpër qytete dhe fshatrat e Kosovës, projekte të ndërtimit të çerdheve e shkollave të reja.

Kemi përkrahur e iniciuar projekte të zonave ekonomike, infrastrukturës rrugore e përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Kemi mbështetur programe për rini e sport, kemi mbështetur programe që synojnë avancimin e fëmijëve me inteligjencë të veçantë, kemi ndarë mjete shtesë për shëndetësinë në nivel lokal, për

trajtimin institucional të qenve endacakë, për financimin e projekteve të komuniteteve joshumicë si dhe në përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Ne nuk kemi mbështetur kërkesa që kanë pasur për synim rritjen e pagave dhe shtesave të pagave.

Ne konsiderojmë se çështje si këto, sidomos diskrepancat e nivelit të pagave, duhet të trajtohen me një ligj të veçantë.

E rëndësishme për t'u përmendur është se në ndryshimet e propozuara është bërë e mundur shpërndarja e mjeteve buxhetore dhe financimi i projekteve kapitale në përfshirje gjithë regjionale.

Rezultat i angazhimit dhe punës intensive, komisioni ka arritur të shqyrtojë pjesën tekstuale dhe tabelare të projektbuxhetit dhe Kuvendit i ka propozuar raportin në fjalë.

Unë dëshiroj të falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit dhe stafin teknik të komisionit dhe Ministrisë së Financave që kanë bërë punë të shkëlqyer.

Para se të rekomandoj, i nderuar kryetar, në raportin që është shpërndarë te deputetët në gjuhën shqipe ka një gabim teknik, në gjuhën serbokroate është në rregull.

Amendamenti 7, pika 1.2 nuk duhet të hidhet në votim, sepse është votuar ndryshe, por është një lëshim teknik që ka ndodhur në proces.

Dhe, për fund, komisioni i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e amendamenteve të propozuara dhe ato që kanë përkrahjen e komisionit.

Ndërsa amendamentet pa përkrahjen të komisionit të mos i miratojë, të cilat përveç se nuk përmbushin kushte teknike, nuk kanë as mbulueshmërinë e buxhetit nga kursimet e brendshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani në qoftë se dëshirojnë e kanë fjalën, t'i lexoj, komisionet e përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, i Qeverisë, kemi deputetët Glauk Konjufca dhe Islam Pacolli.

GLAUK KONJUFCA: Prej kur ekziston kjo Qeveri, për herë të parë po i shohim gati krejt ministrat këtu.

Unë nuk e paskam ditur që problemi paska qenë te rritja e rrogave, për të ardhur këtu të gjithë.

Leximi i dytë i buxhetit po bëhet dy ditë pas një vendimi shumë kontrovers dhe të gabueshëm të kryeministrit që me vendim t'i rrisë pagat e gjithë kësaj morie të ministrave, e të mos flasim për zëvendësministra që kanë kapërcyer numrin 70, kjo është një barrë e konsiderueshme buxhetore, sepse po flasim për buxhetin.

Shumë më mirë do të ishte ky vendim i keq të ishte marrë përpara shqyrtimit të buxhetit, që ne edhe në pasqyrat e buxhetit ta shihnim koston që do ta ketë Republika e Kosovës, koston vjetore, për shkak të një vendimi të tillë, i cili mendoj që është konflikt i qartë i interesit.

Shembulli më i keq në Republikën e Kosovës është nëse zyrtarët publikë ato kompetenca që i kanë, i shfrytëzojnë për t'ia rritur pagën vetvetes. Kjo është shumë keq të ndodhë në Republikën e Kosovës, është konflikt interesi.

Edhe ne duhet aplikuar shembullin amerikan në këtë drejtim që kongresistët nuk mund t'ia rrisin pagën vetvetes dhe për legjislaturën e caktuar, po munden veç për legjislaturën e ardhshme.

Pra, për persona të cilët do të vijnë pastaj, ku të gjithë do të konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe aty dihet kush do të jenë zyrtarët e ardhshëm. Ama, të vendosësh për vetveten, t'ia rritësh vetvetes pagën, sapo i ke marrë kompetencat, dhe t'ia rritësh pagën vetvetes 120%, si shpërblim që i ke bërë 100 ditë qeverisjeje, atëherë shtrohet pyetja çka do të ndodhë kur i bëni 200 ditë, se për 100 ditë ju e shpërblyet vetveten. Po tash e kam pyetjen 200 ditë kur të bëhen, çka do të ndodhë?

Sa i përket buxhetit, mënyra si bëhen amendamentet te ne, nuk pajtohem absolutisht. Vetëm shikojeni, këtu e keni, për shembull, amendamentin 15.

Amendamenti 15 i ka 25 projekte, 25 projekte, të cilët kanë kosto dhjetëra milionëshe, me një amendament. E keni bërë bashkë dhe i keni shtirë bashkë krejt.

Nuk ka precedent në botë si bëhen amendamentet e buxhetit tonë, siç ndodh këtu në Republikën e Kosovës.

Unë mund të jem, për shembull, në amendamentin 15 kundër projektit 1.17, ama jam për të gjithë këto të tjera. Edhe unë tash e kam dilemën, si mund të mos e votoj pikën 1.17, kur më duhet ta votoj krejt amendamentin, krejt amendamentin 15. Aty janë 25 projekte, secili amendament i ka nga gjashtë projekte, shtatë projekte, me gjysmën prej tyre brenda amendamentit pajtohem dhe dua t'i votoj, për të tjerat jam kundër.

Ju na keni vendosur përpara një sfide, e cila nuk ka qenë fare e nevojshme. Për secilën prej projekteve duhet të ketë amendament të veçantë.

Unë këtë formë të leximit të dytë të buxhetit e propozoj, tash është vonë, por për hera të tjera e në këtë duhet të kontribuojë edhe Qeveria. Nuk mund t'i fusësh 25 projekte me një amendament, secili e ka mendimin e vet për ato projekte, dikush do ta votojë njërin për, tjetrin kundër.

Tash e keni pamundësuar që për secilin projekt deputeti të votojë. Kjo bën të rriten vota kundër për secilin amendament në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe nëse qëllimet janë të mira, edhe nëse projektet janë të nevojshme, ju do ta rritni në këtë mënyrë votën kundër.

Sepse dy projekte, nëse prej atyre 25-ve janë të dëmshme, sipas mendimit tim, unë amendamentin 14 do ta votoj kundër, veç për shkak të atyre dy projekteve. Për 23 të tjera mund të pajtohem, domethënë definitivisht kjo formë e buxhetit propozoj të ndryshohet në të ardhmen.

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Sa i përket vendimit për të cilën foli edhe Glauku në emër të Grupit Parlamentar, sigurisht që është e papranueshme, por ju njoftojmë se e kemi dërguar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, për faktin se është konflikt interesi që t'i rritet vetit paga, e po ashtu është vepër penale.

Madje, aty e pashë që edhe ministri i Drejtësisë më duket që ka votuar për atë vendim. A është e vërtetë, zoti ministër, sepse kjo është në shpërputhje me deklaratimet tua. Në vazhdimësi thoni që do ta luftojmë krimin e korrupsionin, do ta parandalojmë konfliktin, por ke votuar edhe vetë për rritje të pagave, domethënë edhe ju keni bërë vepër penale sikurse edhe kryeministri dhe ministrat e tjerë.

Por po ashtu do ta dërgojmë edhe në Gjykatën Kushtetuese, sepse është në shpërputhje me gjendjen socio-ekonomike dhe nuk e di, zoti kryeministër, si ka mundësi të ndihesh i qetë kur e ke pagën më shumë se 10-fishi i pagës mesatare në vend, ose 40-fish më shumë se pensionistët. Nuk e di se qysh po mendon të punosh për qytetarët e Republikës, sepse kjo shpërputhje e madhe në paga nuk mendoj që të nxitë të punosh për popullin, po për vete.

Qëllimi pse e mora fjalën është për shkak se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka përkrahur asnjë amendament të Komisionit për Legjislacion, jo amendament që kam dërguar si deputete, por si Komision për Legjislacion dhe, me sa e di, asnjëri prej komisioneve parlamentare nuk ka dërguar amendamente, përveç Komisionit për Legjislacion dhe nuk janë amendamente që nuk është dashur të përkrahen, për shkak se kanë pasur të bëjnë pikërisht me fuqizimin e sistemit të drejtësisë, për të cilin po flasin në vazhdimësi.

Mirëpo, me që Komisioni për Buxhet nuk i ka përkrahur, unë për secilin amendament do të kem arsyetim dhe pres votën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Asnjë deputet s'ë ka kërkuar fjalën, as Qeveria.

Në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 janë propozuar 101 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa.

Para se të futem në amendamente, në qoftë se e keni marrë mocionin, e kishim përfunduar votimin. Nuk ka ardhur ende, në rregull.

Vazhdojmë me amendamente, po shkojmë ngadalë, njëherë pjesën e parë, pastaj jemi në pjesën e amendamenteve, në pjesën tekstuale të projektligjit.

Amendamenti 1, me mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Edhe një herë, jemi në pjesën e amendamenteve, në pjesën tekstuale të projektligjit. Janë të gjitha të mbështetura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, janë gjashtë aktualisht, unë do të shkoj një nga një, në qoftë se kalojnë nga 61 deputetë. Shkojmë në mënyrë elektronike për secilin, apo dëshironi në mënyrë formale? Elektronike? Shkojmë në mënyrë elektronike, një nga një.

Amendamenti 1, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

94 deputetë kanë votuar, 74 për, 17 kundër, 3 abstenime. Kalon!

Amendamenti 2, po ashtu me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar, 78 për, 2 kundër, 5 abstenime. Kalon!

Amendamenti 3, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Zoti Avdullah Hoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë kam një koment, ndoshta sqarim, se si po mendon ministri ta procedojë, sepse ka qenë praktikë në të gjitha buxhetet që në rastin kur për një kontratë duhet dhënë paradhënie deri në 100% të vlerës së kontratës, është marrë gjithmonë rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Tash nëse ia lë këtë barrë ministrit, në rregull, nëse do ministri ta marrë këtë përgjegjësi

të plotë që në rastin e kontratave specifike kur duhet 100% të jepet paradhënie, unë jam në rregull, veç ta konfirmojmë, sepse ka qenë një praktikë që në raste të tilla është involvuar edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju! Ministri i Financave e ka fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Qeveria ka proceduar në Kuvend projektligjin, ku ka qenë e përfshirë që Komisioni për Buxhet dhe Financa të japë rekomandimin e vet. Kjo është kërkesë e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk është kërkesë e Qeverisë, nuk është nevojë e Qeverisë, prandaj Kuvendi le të vendosë.

KRYETARI: Atëherë, faleminderit! Shkojmë në votim!

Amendamenti 3, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar, 61 janë për, 2 kundër, 11 abstenime. Kalon!

Amendamenti 4, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

78 deputetë kanë votuar, 69 për, 2 kundër, 7 abstenime. Kalon!

Amendamenti 5, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Urdhëroni, zonja Pacolli, e kërkoni fjalën? Atëherë, ka mundësi të votoni me dorë, në qoftë se keni problem me kartelë. Ata të cilët kanë problem me kartela, mundësisht i bashkëngjiten votimit edhe me dorë. Cila ishte vota juaj herën e kaluar? A dëshironi ta deklaroni. Vetëm po-jo.

FITORE PACOLLI: Vota ime ishte abstenim.

KRYETARI: Abstenim! Atëherë, Sali Salihu, po ju shoh, keni kërkuar fjalën. Po, urdhëro.

SALI SALIHU: Kryetar, nuk janë duke punuar një varg i aparaturave këtu që i kemi përpara, nuk është në pyetje vetëm një.

KRYETARI: Atëherë, kisha kërkuar në moment kur e shihni që s'punon aparatura, e çoni dorën, e konstatojmë numrin e deputetëve që s'kanë mundur të votojnë, por në të njëjtën kohë përsëri ju pyes për votën tuaj. Po edhe një gjë duhet të keni parasysh, ka një rrezik që çdoherë duhet të

verifikohet nëpërmjet teknikës. Do të thotë, këtë ta keni parasysh edhe për publikun. Mund të ndryshojë në qoftë se regjia tregon që keni votuar, por tek ju tregohet e paqartë vota juaj.

Në momentin kur e shoh që një votë apo dy janë vendimtare, atëherë e përsëris votimin dhe shkojmë në votim pak më të qartë. Kur si tash janë 80 vota, në qoftë se edhe Sali Salihu s'ka votuar, s'i ka punuar teknika, bëjnë 80, atëherë 81. A e lëmë këtë herë këtë votë, e cila është pranuar në mënyrë elektronike, se s'ka ndikim, e pastaj ju lutem nëse s'punon, çoni dorën.

Armend Zemaj, vetëm ta konstatoj këtë votim, le të përfundojë ky amendament.

78 deputetë kanë votuar. 69 janë për, 2 kundër, 7 abstenime.

Jemi te amendamenti i pestë, urdhëro, zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryetar, kisha kërkuar që për të mos e komplikuar votimin, të evidentohet pjesëmarrja.

KRYETARI: Më fal, ka problem edhe me zërin.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Kisha propozuar për të qenë më racionalë dhe të mos komplikohet situata, mund të evidentoni pjesëmarrjen e deputetëve dhe ata që janë kundër ose që abstenojnë, ta ngritin dorën. Pjesa tjetër, ata që pajtohen, llogariten për, deri te amendamentet që vijnë te deputetët pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Ata që kanë për të diskutuar për amendamente paraqiten për fjalë, do të ishte më racionale dhe nuk komplikohet mënyra e votimit. Ky është propozimi im, ndërsa nëse mundeni tash ta nxirrni deklaratën, sepse ka kërkesa nga deputetët para se të hyjmë në pjesën e diskutimeve, sepse janë 101 amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Ta përfundojmë edhe amendamentin e gjashtë në këtë formë, pastaj shkojmë në votim të mocionit, në të njëjtën kohë kemi një propozim në të kaluarën e kemi bërë shpesh, kemi shkuar me të gjitha amendamentet, bile i kemi përmbledhur kur nuk ka pasur kontestim, sido që të jetë, ju e vendosni, shkojmë një nga një, po mendoj në mënyrë formale vetëm.

Shkojmë edhe te amendamenti i gjashtë, pastaj e votojmë.

Amendamenti 5, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

79 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike. 74 për, 1 kundër, 4 abstenime. Edhe në qoftë se ka probleme, po kalojmë një herë në këtë pjesën e amendamenteve.

Amendamenti 6, me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar. 74 për, 2 abstenime. Kalon edhe ky amendament!

Të nderuar kolegë deputetë, para jush e keni një mocion të dorëzuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Avdullah Hoti. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Urdhëro, Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Siç u deklarua edhe në fillim, ne absolutisht e mbështesim një qëndrim të tillë kundërshtues me gjuhën fyese të përdorur ditë më parë, por ne propozojmë që të plotësohet paragrafi i dytë dhe të mos përmenden vetëm veprimtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe veprimtarët e partive të tjera politike apo aktivistë të tjerë politikë të lëvizjes kombëtare, të cilët janë vrarë dhe të cilët sot e kësaj dite nuk dihet për fatin e tyre apo çka ka ndodhur.

Kështu që në frymën e konsensusit dhe të gjithë përfshirjes, qysh nga dita e djeshme në Kryesi, propozoj që të shtohet kjo dhe nuk besoj që ka dikush kundër zbulimit të vrasjeve të cilido aktivist politik në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Të mos e komplikojmë, e shtojmë edhe atë pjesë. Vetëm pak, mos e ngarkoni diçka çka është mirë të jetë koncensuale. Shtoni edhe një paragraf, nuk do të dalim nga seanca pa e votuar.

Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne propozojmë që ky mocion të hedhet në votim, unë pashë deklarinimet e shefave të grupeve parlamentare që kishte një përkrahje të plotë. Ajo që kërkon zoti Krasniqi është e përfshirë në paragrafin tre dhe një gjë tjetër, kjo deklaratë, ky mocion lidhet me një deklarinim specifik që një person ka bërë para dy ditësh për veprimtarët e LDK-së, në mënyrë specifike, pra kjo deklaratë lidhet me atë deklarinim të atij personi.

Kushdo që në të ardhmen e jep një deklaratë fyese, denigruese për këdo, ne do të jemi prapë, do të marrim iniciativën që këtij Kuvendi t'ia propozojmë një mocion tjetër përmbajtjesor, por në këtë rast specifik ne jemi duke adresuar deklarinimin e zotit Haradinaj për vrasjet e veprimtarëve të LDK-së dhe kërkoj nga gjithë deputetët e Kuvendit që ta aprovojnë, ta mbështesin këtë deklaratë kështu si u lexua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe një situatë, në gjuhën serbe s'qenka përkthyer ende. Procedojmë derisa të përkthehet edhe në gjuhën serbe, se kolegët e Listës Serbe kërkuan që ta kenë para tyre, ju merreni vesh ose futemi në votim. Atëherë, vazhdojmë?
Milaim Zeka e ka kërkuar fjalën, por të vazhdojmë me rendin e ditës.

MILAIM ZEKA: Kryetar, unë i kisha lutur deputetët, sidomos të krahut tonë të mos rroken pas gjërave shumë të vogla, e ndoshta edhe banale. Po flasim për një rast konkret, po flasim për një deklaratë të dikujt dhe s'kemi nevojë këtu të na lodhin me debate. E votojmë ashtu qysh na e kanë sjellë këta, e para. E dyta, po e përfundoj, të lutem të na lëshoni pak ajër se jemi bërë si Pallati i Drejtësisë, sa s'po vdesim prej vape.

KRYETARI: Po vazhdojmë seancën, në qoftë se kemi mirëkuptimin. Le të kryhet edhe në gjuhën serbe, është procedurë. Shkojmë në votim, vazhdojmë me amendamentet e propozuara në pjesën...

Kolegë deputetë, kryetar i Listës Serbe, në qoftë se jeni gati, po futemi në proces të votimit, një deklaram të shpejtë. Zoti Sasha Milosavljeviq, në qoftë se jeni gati, një deklaram të shpejtë. Ndërkohë, Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën. Haxhi Avdyli a e dëshironi edhe ju fjalën.

BILALL SHERIFI: Jam i vetëdijshëm, sikur unë dhe të gjithë deputetët këtu që kemi të bëjmë me një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme, por besoni së paku përshtypja ime është kjo, duke tentuar me çdo kusht të bëjmë diçka të mirë, ju lus për mirëkuptim, jo të keqkuptohemi, po të kuptohem seriozisht dhe sinqerisht se çka po dua të them.

Paragrafi i parë, kryetar, të nderuar kolegë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sidomos juve, thotë: "Kuvendi i Republikës së Kosovës dënon gjuhën fyese dhe të urrejtjes të përdorur nga përfaqësuesi i OVL të UÇK-së për vrasjet politike të veprimtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës". Ajo që po bëjmë ne, po e dënojmë dikë që ka përdorur një gjuhë fyese, ne këtu po marrim një vendim që i takon gjyqësorit, të nderuar. Ju luta për mirëkuptim, jo të bëjmë politikë. A është vrasje politike, me motive politike, nuk na takon neve ta caktojmë. Ne duhet të themi kundër vrasjeve të veprimtarëve politikë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, t'ua lëmë të tjerëve të vendosin për motivet, sepse në fund të fundit, motivi shpeshherë përcakton, kur e gjen motivin, e gjen edhe vrasësin, e gjen edhe urdhërdhënësin. Prandaj, unë ju lus për mirëkuptim, ta zhvendosim, politike është, por veprimtarët kanë qenë politikë, por jo motivi. Ne këtu si Kuvend, organ legjislativ politik, po marrim rolin e prokurorit, e hetuesit, e gjykatësit të shkallës së parë, shkallës së dytë dhe po vijmë në përfundim që vrasjet paskan qenë politike.

Ju lutem, për mirëkuptim dhe nuk është qëllimi të hap debat, por kjo do të mbetet sot e 1 vit, 10 vjet, 100 vjet si dokument i Kuvendit të Republikës së Kosovës që ka marrë drejtësinë në dorë dhe ka shpallur para se të kapen vrasësit, urdhërdhënësit, motivet për vrasjen. Natyrisht që askush nuk mund ta kontestojë faktin që ata kanë qenë veprimtarë politikë, por t'ua lëmë të

tjerëve t'i përcaktojnë motivin. Ata për të cilët Kushtetuta ua ngarkon këtë mandat, këtë shqetësim e pata, me sinqeritetin më të madh, jo me qëllim që të hap debat dhe jo me qëllim për të kundërshtuar idenë e mocionit. Faleminderit paraprakisht për mirëkuptim!

KRYETARI: Vetëm pak, kanë filluar shumë deputetë, po shkëputemi prej pjesës qenësore. E miratojmë deklaratën, mos e politizoni. S'keni nevojë të politizoni në këtë moment. Po lajmërohen shumë deputetë, po futeni në diskutime pastaj...

Haxhi Avdyli e ka kërkuar fjalën, po e shoh po insistojnë, Arbër Rexhaj, Ahmet Isufi, Zafir Berisha dhe nënkryetari Kujtim Shala.

Nënkryetari Kujtim Shala, po e shoh reagimin nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pastaj nga grupet parlamentare le të lajmërohen, po mirë është ta përfundojmë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që teksti është i saktë dhe i qartë dhe është në frymën e qëndrimit të Kryesisë së Kuvendit, sepse mbrëmë e kemi diskutuar gjatë. Unë dëshiroj të saktësoj për dy gjëra dhe pastaj kërkoj të votojmë, të deklarohe mi. E para, ky s'është një problem gjuhësor, por vrasjet e veprimtarëve politikë janë vrasje politike, i thatë ose jo, janë vrasje politike dhe, e dyta, ky është një dokument politik, po është deklaratë dhe nuk është një akt gjykim. S'gjykojmë askënd dhe s'vendosim për asgjë, shprehim nëpërmjet një deklarate të saktë, të qartë, një qëndrim politik të institucionit themelor të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: OK! Arbër Rexhaj nga Lëvizja "Vetëvendosje" e ka kërkuar fjalën.

ARBËR REXHAJ: Unë e kam një vërejtje, pa dashur të hyj në aspekte politike, këtu thotë: "Kuvendi i Republikës së Kosovës dënon gjuhën fyese dhe të urrejtjes të përdorur nga përfaqësuesi i OVL të UÇK-së". Domethënë ajo deklaratë a është lëshuar si përfaqësues i OVL të UÇK-së, pra duhet ta konkretizojmë dhe së dyti, mëndoj se duhet të përcaktohet data, pra kush është, sepse është e përgjithshme, nuk është precize dhe po mëndoj që megjithatë është jashtëkonceptuale. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Zafir Berisha nga "Nisma".

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë konsideroj se duhet të theksohet të gjitha vrasjet e pasluftës që kanë ndodhur në Kosovë, jo të specifikohet vetëm dikush, një subjekt, se ka pasur edhe ushtarë të vrarë të UÇK-së, ka pasur edhe personalitete të ndryshme, le të specifikohet që të gjitha vrasjet që kanë ndodhur pas luftës në Kosovë.

KRYETARI: Zoti Zafir Berisha, Haxhi, a e largove atëherë s'prish punë. Zafir Berisha, Haxhi Avdyli, më duket s'ka më diskutues.

ZAFIR BERISHA: Zoti kryetar, unë një herë fillimisht si deputet, si Zafir Berisha njihem shumë keq që Kuvendin e Republikës e keni sjellë në këtë situatë. Me qindra, për të mos thënë, me mijëra herë ka pasur ofendime dhe fyerje edhe mes vete edhe në drejtim tuajin, edhe të njëritjetrit dhe asnjëherë nuk kemi bërë deklaratë për t'u tërhequr. Përveç që jam kundër, kisha kërkuar të mos tallemi me dhembjen, vuajtjet e njerëzve dhe të mos luajmë me ndjenjat e qytetarëve. Ne e dimë që ka pasur shumë vrasje, pika dy është domethënë presion mbi organet e drejtësisë. Në fund të fundit, për të satën herë ne organeve të drejtësisë duhet t'u tregojmë tash e 17 vjet të merren me këto gjëra. Kështu që ne po nxjerrim deklaratë kotë, siç kemi nxjerrë edhe shumë rezoluta kotë për raste nga më të ndryshmet, por përfaqësojmë edhe të kësaj natyre.

Kështu që mos e maltretoni këtë Parlament dhe vazhdojmë të punojmë për çka jemi të thirrur. Organet e drejtësisë e dinë tash e 17 vjet që vrasësit duhet të zbulohen, duhet të shkojnë në burg. Çka po na duhet neve pas 18 vjetëve edhe një herë të dalim, nesër del një deklaratë e dikujt tjetër dhe Parlamenti sikur të mos ketë punë më të mençura. Kështu që unë po mendoj që duhet t'i ndalim talljet me këtë organ të lartë të shtetit dhe të merremi seriozisht me punët që na takojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Po zgjerohet, është Haxhi Avdyli, Vjosa Osmani, Ismajl Kurteshi. Ju lutem, unë do t'ia jap fjalën Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Mendoj që kjo është një deklaratë pozitive, nuk ka asgjë të keqe nëse ne solidarizohemi me të gjithë ato viktimat, me familjarët e tyre dhe dalim kundër një gjuhe degraduese, një gjuhë fyese që u është bërë me qëllim apo pa qëllim ndaj të vrarëve të pasluftës, ku decidivisht thuhet "punë e madhe që janë të LDK-së".

Ne dënojmë çdo rast dhe nëse ka nevojë për deklaratë të tjera, do të aprovojmë edhe deklaratë të tjera, por mendoj që të vazhdojmë me procedimin e kësaj deklarate dhe e përsërisht përkrahjen që ia dhanë të gjitha grupet, të mos vazhdojmë më të hapim debat, të nxisim çështje të tjera, të vazhdojmë votimin edhe ta shohë qytetari kush është kundër gjuhës fyese, sepse ne vetëm po dalim me një deklaratë kundër gjuhës fyese, ne nuk po vendosim as gjyqësi, as nuk po e dënojmë askënd, por ne vetëm po e dënojmë gjuhën fyese. Mendoj që ky është një hap i mirë për skenën politike nëse ne dalim kundër një gjuhe të kujtëdo qoftë, nëse nesër del edhe një deklaratë fyese e dikujt, pa marrë parasysh ne do ta përkrahim. Por, mendoj që është edhe një fyerje e dytë për të vrarët dhe familjet e tyre nëse e iniciuam këtë deklaratë dhe dështojmë këtë deklaratë. Kjo është edhe një vrasje e dytë për ato familje, të cilat sot e presin këtë deklaratë, një lloj solidarizimi me ta. Faleminderit!

KRYETARI: Vjosa Osmani, pastaj Ismajl Kurteshi.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Më duhet patjetër të reagoj ndaj pretendimeve që një deklaratë me një gjuhë të tillë është presion ndaj gjyqësorit. Absolutisht, asnjë fjalë që është në përmbajtjen e kësaj deklarate nuk është presion, është thirrje e një institucioni publik, pra i Kuvendit të Republikës që institucionet e drejtësisë thjesht ta kryejnë punën e tyre me paanshmëri, me profesionalizëm, me seriozitet dhe vetëm në përputhje me ligjin dhe me Kushtetutën.

Në qoftë se Kuvendi kualifikohet se po bëka presion mbi drejtësinë për një thirrje të tillë, atëherë të njëjtat akuza do të duhej t'u bëheshin edhe institucioneve të tjera kur kanë bërë thirrje, përfshirë edhe kryeministrin, i cili së fundi u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë për t'u zbardhur vrasjet e pasluftës. E dyta, për ta përsëritur qëndrimin e kolegëve të mi, paragrafi i tretë u referohet të gjitha vrasjeve politike, madje edhe të gjitha krimeve të tjera të pandriçuara në Republikën e Kosovës, sepse vetëm duke u ndriçuar ato, Kosova mund të konsiderohet shtet ku sundon ligji dhe e drejta. Dhe, e treta, ka pasur vërtet raste kur ky Kuvend ka bërë presion mbi drejtësinë. Ju kujtohet vetë grupet parlamentare që tashmë janë pjesë e koalicionit qeverisës inicicionin rezoluta për rastet që akoma ishin duke u gjykuar. Në ato raste ne nuk kemi kundërshtuar, sepse e kemi kuptuar, pavarësisht çka ka qenë përfundimi apo vendimi përfundimtar i gjyqësorit, presion është kur përderisa rasti po gjykohej, të vendoset në këtë Kuvend se çfarë provash duhet të merren parasysht e cilat nuk duhet të merren parasysht.

Ka pasur edhe raste të tjera, për shembull, kur është kërkuar hetim ndërkombëtar për rastin e Astrit Deharit, kur ne si LDK e kemi përkrahur, mirëpo në qoftë se është nevoja edhe në të ardhmen për vrasje politike apo raste të tjera të pandriçuara të deklarohemi, nuk do të duhej Kuvendi të izolohej dhe të mbetet institucioni i vetëm që nuk reagon ndaj gjuhës fyese dhe ndaj gjuhës së urrejtjes. Përkundrazi, në fakt, tallje do të ishte ndaj familjeve të veprimtarëve të vrarë në qoftë se Kuvendi mbetet i vetmi institucion publik që nuk reagon për një gjuhë të tillë. Prandaj, ne si LDK nuk do ta ndryshojmë tekstin, ky tekst duhet të votohet kështu si është.

KRYETARI: Zafir Berisha replikë, Ismajl Kurteshi bëhet gati dhe jemi në përfundim.

ZAFIR BERISHA: Domethënë, sipas Vjosës, të kërkosh para organeve të drejtësisë po u nënkuptuaka që ato nuk po e ditkan, po ne po u dashka t'ua kujtojmë. Unë e thashë, shpreh keqardhje dhe thjesht, me gjasë gjithë kjo zhurmë u bë pa nevojë. Unë do të jem kundër, mendoni si të doni, privatisht e dini mendimin tim për këtë çështje, por e dini edhe publikisht, por jo të bëhet lodër Kuvendi i Kosovës. Unë do të votoj kundër kësaj deklarate, sepse një herë e përgjithmonë duhet thënë stop deklaratave koti, edhe për rezoluta të tjera kam thënë që kanë qenë rezoluta koti dhe e dini që s'kanë bërë asgjë.

Edhe në rast se e nxjerrim një deklaratë, mos mendoni që ua heqim dhimbjen familjarëve, të cilët i kanë humbur më të dashurit. Vetëm jemi duke ua shtuar dhimbjen, për t'ua hequr dhembjen është dashur tash e 17 vjet vrasësit të ishin nëpër burgje, por jo ne sa herë kemi nevojë të çojmë pluhur dhe të bëjmë dokrra në Kuvend vetëm për t'u bërë lajm nëpër portale, të nxitim deklarata, debate dhe fjalime të ashpra, është më shumë se qesharake dhe është torturë për qytetarin, sipas mendimit tim. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Vjosa, unë po frikësohem se s'po doni ta kaloni rezolutën, veç po na vononi. Të shkojmë në votim dhe ta përfundojmë. Unë, s'e kam ndërmend t'ua ndal. Vjosa Osmani-Sadriu, kundër-replikë. As rregullorja nuk e sheh këtë farë pune, po hajt!

Urdhëroni, zonja Vjosa, por po zgjatemi, se s'kam kundër...

VJOSA OSMANI: Është vetëm përgjigje. Po, ka nevojë t'ua rikujtojmë institucioneve të drejtësisë sepse plot 17 vjet familjarët e personave të vrarë po maltretohen duke u marrë në pyetje vazhdimisht dhe deri tani asgjë nuk është bërë.

Pra po, ka nevojë, sepse sikur të mos kishte nevojë asnjëra nga institucionet publike nuk do t'i bënin thirrje edhe Prokurorisë, edhe Gjyqësorit që të reagonin. Nuk është presion, është kryerje e detyrave tona kushtetuese si Kuvend.

KRYETARI: Të lutem! Urdhëro Ismajl Kurteshi, dhe po shkojmë në votim.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha ta shpreh mospajtimin tim me konstatimin e një parafolësi, i cili tha se motiv i vrasjeve të veprimtarëve politikë është përherë vrasja politike.

Vrasja e veprimtarëve politikë mund të jetë e motivuar politikisht, por kjo nuk do të thotë, mund të jetë edhe e motivuar nga ndonjë arsye tjetër. Prandaj, cilësimi se vrasjet janë politike mund të jetë teprim nga Kuvendi dhe është mirë të shqyrtohet, kurse në rreshtin e fundit, paragrafi 2, mendoj se duhet të shtohet edhe fjala "kryerësit", aty ku thuhet "profesionalizëm dhe paanshmëri dhe kryerësit ta marrin dënimin e merituar", duhet treguar kush duhet ta marrë dënimin e merituar dhe ndoshta do të ishte mirë që për veprimtarët, në vend të "LDK-së", të jetë "veprimtarë politikë", sepse edhe kanë qenë veprimtarë politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar nga Administrata që t'i thërrasë deputetët, ata që duan të vijnë, dhe shkojmë në votim. Po e përfundojmë. Nënkryetari ka vetëm diçka procedurale dhe shkojmë në votim. Nënkryetari, Kujtim Shala urdhëro!

KUJTIM SHALA: Faleminderit! Unë po e përsëris edhe një herë atë që e thashë, edhe pse ishte krejt e qartë. E kam thënë saktësisht këtë: “vrasjet e veprimtarëve politikë janë vrasje politike”. Këtë e dimë të gjithë. Nëse kjo përcakton motiv, është çështje tjetër, këtë s’e përcaktoj unë. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi urdhëro, dhe përgatitemi për votim.

BILALL SHERIFI: Kryetar, sërish e paragjykove nënkryetarin, the “procedurë”. E a po e sheh që s’e paska pasur procedurë. Mos e paragjyko.

Unë dua t’i thërras edhe një herë në mirëkuptim, të gjitha grupet parlamentare e mbështetën idenë e një deklaratë nëpërmjet së cilës Kuvendi do të shprehej kundër qasjeve të tilla, të kujtdo qofshin, në këtë rast të përfaqësuesit të UÇK-së, zotit Nasim Haradinaj. Për këtë çështje jo se kemi dallime, por zakonisht këtu në Parlament ka pasur një praktikë, kur një grup parlamentar e ka ngrehur një mocion, shefat e grupeve kur kanë kërkuar mbështetjen e grupeve tjera, sidomos në këtë rast të gjithë Kuvendit, kanë mbajtur takime, kanë mbajtur konsultime paraprake që ta harmonizojnë tekstin. Kolegët nga LDK-ja na kanë vënë para një situatë “ose merre, ose lëre”. Nuk është korrekte. Pra, “nëse e lini nuk jeni për t’i dënuar këto, nuk bashkëndjeni me familjet e viktimave, pra ju jeni sikur ata...”, ndërsa kur nuk afrohem ne që të ofrojmë zgjidhje, akuzoni se nuk dëshironi fare të bashkëpunoni. Pra, hajde të ulemi dhe ta harmonizojmë tekstin.

U dëgjuan këtu tri-katër propozime për të ndërhyrë, vërejtje të vogla, për të ndërhyrë në tekst, për ta bërë një tekst të përbashkët dhe të dalim ta votojmë. Kjo kështu, “merre ose lëre”, i vëni deputetët para një situatë që kush voton për është me drejtësinë, është me familjet e viktimave, kush voton kundër është me ata që shprehen në mënyra të tilla. Besoni, nuk është korrekte, unë po përpiqem ta jap kontributin tim, që mocioni të kalojë, por një mocion me të cilin të gjithë do të ndiheshim të përfaqësuar, e jo një mocion me të cilin do të ndiheshim të detyruar për ta votuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qëndrimet tanimë janë të qarta. Shkojmë në votim. Deputetë të nderuar, mocionin e keni para vetes. Është i paraqitur nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Avdullah Hoti.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 78 deputetë, për janë 67, kundër është 1, abstenime 10.

Kush është pa kartelë? Zoti Arban Abrashi pa kartelë është për, tjetër s’ka.

Vazhdojmë me amendamentet në pjesën tabelare të projektligjit.

Atëherë, kështu: Jemi në amendamentin e shtatë, me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, me vërejtjet që i dha kryetari i komisionit, të hiqet pika 1.2.

Shkojmë në votim! Para se të shkojmë në votim, a dëshironi të shkojmë në votim sikur këto 6 amendamentet e para, apo dëshironi formalisht? Formalisht!

Unë do të them vetëm kush është kundër, kush abstenon dhe në qoftë se shumica e pranishme nuk reagon, unë e marr për po. Ka edhe një zgjidhje, prej amendamentin 7 deri te 29 mund të shkojmë me një votim, në mënyrë elektronike. Si të doni, ju e vendosni. A e hedh në votim formalisht, në mënyrë elektronike, në qoftë se është po, apo ka shumë jo. Sa veta janë jo, çojeni dorën! Krejt këta të tjerët janë për po. Veç nuk është korrekte, pasi shumica absolute janë po, të mos shkojmë.

Shkojmë në mënyrë elektronike, amendamenti 7 deri te amendamenti 29, natyrisht amendamenti 7 me vërejtjet që i ka dhënë kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në qoftë se ka një përjashtim, kolegë deputetë, nga 7 deri 29, nëse keni ndonjë përjashtim, përjashtojeni.

Unë mund të shkoj një nga një, por më dhimbseni.

Amendamenti 7.

Regjia dhe deputetët, me vërejtjet e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, hiqet pika 1.2.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash, në mënyrë elektronike.

A ka deklaram me dorë, se nuk ka arritur të votojë? Jo!

83 deputetë kanë votuar, 74 për, 5 kundër, 4 abstenime.

Amendamenti 8.

Me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: 93 deputetë kanë votuar. 93 për. Miratohet amendamenti 8.

Vazhdojmë kështu normalisht të votojmë. Nëse ka dikush, le të lajmërohet. Zonjë, si e ke hallin? Për apo kundër? A dëshiron të diskutosh? Zonja Pacolli-Dalipi e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Përshëndetje!

Bëhet fjalë për amendamentin 9, pika 1.7, në të cilin flitet për investimet kapitale në arsimin parauniversitar, pra kërkohet që të barten mjetet për ndërtimin e shkollës fillore në Sverkë, në Pejë. Kur e shohim planin e ndërtimit të shkollës është për keqardhje se si kjo mendësi e vjetër politike po vazhdon edhe në këtë qeverisje.

Pra, kemi ndërtimin e shkollës, e cila nuk ka sallë të edukatës fizike, nuk ka kuzhinë, nuk ka bibliotekë, pra ka vetëm tri klasë dhe sallë të arsimtarëve. Mungon edhe banja për staf profesional, për edukatorë. Pra, nuk ka as hapësirë rekreative në oborrin e shkollës. Kjo është ajo mendësia e vjetër politike, ku në secilën komunë të Republikës së Kosovës tashmë kemi shkolla pa sallë të edukatës fizike. Pra, mungojnë hapësirat e nevojshme në secilën shkollë, të cilat janë ndërtuar pas luftës në Republikën e Kosovës.

Prandaj, kërkohet që ndërtimet të tilla të mos aplikohen dhe Ministria e Arsimit duhet të ndërhyjë në këtë rast, e të mos lejojë ndërtimin e shkollave pa sallë të edukatës fizike, pa kuzhinë, pa hapësira rekreative, sepse janë të nevojshme, sidomos në shkollat nëpër fshatra. Po ashtu është mirë që në shkollat që ndërtohen në fshatra, ku nuk ka mundësi të ndërtohen çerdhe, të inkorporohen paralele, ku mund të hapen edhe klasat për çerdhe për fëmijët në edukimin parafillor dhe parashkollor. Kështu që është e nevojshme dhe e domosdoshme që investimet e tilla të ndërpriten sa më shpejt të jetë e mundur, pra nëse investojmë në shkolla të investojmë tamam siç duhet, duke plotësuar kriteret për secilin fëmijë, e jo të bëhet diskriminim, të investohet në shkolla nëpër fshatra pa salla të nevojshme për zhvillimin e fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vërejtja është me vend. Sidoqoftë në rishikim të buxhetit, nëse Qeveria e sheh të nevojshme do ta bëjë atë. A e do fjalën, Kujtim? Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë meqë e njoh dëshiroj të sqaroj, se është fjala për një paralele të ndarë, domethënë i gjithë diskutimi është i kotë, sepse premisa është gabim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu, urdhëro!

Kjo si ide është e mirë për shkolla, por edhe unë e di si halli aty dhe...

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Vetëm po dua ta bëj një sqarim të vogël dhe ta plotësoj deputeten e nderuar.

Deri në vitin 2008, vetëm në Komunën e Skenderajt kanë qenë 8 shkolla në baraka. Nevojat për investime në shkolla kanë qenë emergjente dhe nuk është e vërtetë që janë ndërtuar shkolla pa salla të edukatës fizike. Ka shkolla në Kosovë çfarë as në Evropë nuk ka, që janë ndërtuar nga

viti 2008 deri në vitin 2014. Qasja e tillë, nuk mendoj që deputeti duhet të ftojë të ndërpritet ndërtimi i shkollave. Plotësimet aty ku ka mundësi buxhetore, edhe me sallat e edukatës fizike, është mirë, po është mirë nganjëherë që bile disa që po vijnë prej komunave ta shohin sa shkolla i kanë ndërtuar të tilla, që po kërkojnë këtu në Kuvend.

Vetëm një rikthim për ta parë se sa janë bërë të tilla. Po, duhet të bëhen edhe të tilla, brenda mundësive, e në veçanti që ato të jenë sa më të shfrytëzueshme, edhe në aspektin cilësor, e jo vetëm sasior. Faleminderit!

KRYESUESI: Amendamenti 10.

Po, çfarë po do, pashë Zotin? Hajde, replikë Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,

Ne kemi plotë shembuj që në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kemi shkolla pa salla të edukatës fizike, pa kuzhina, pa hapësira rekreative.

Kështu që mund t'jua sjell edhe me numër se në cilat shkolla mungojnë këto hapësira. Prandaj, është e drejtë e secilit fëmijë, në fshat apo në qytet, të ketë shkollë me standarde që janë të nevojshme. Nuk kërkoja ndërprerjen e ndërtimit të shkollave, kërkoja që secila shkollë që ndërtohet të ndërtohet me standarde që janë në përputhje me standardet evropiane, e jo të kemi shkolla ku duhet të ndërhyhet, të shtohen anekse, të ndërtohen salla të edukatës fizike pas ndërtimit të tyre, të ndërhyhet prapë pas dy-tri vjetëve.

Ne po ashtu kemi shkolla në komunën e Prishtinës që janë ndërtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës atëherë, pra përderisa ka qenë udhëheqëse në Komunën e Prishtinës dhe shkollave të reja tashmë u rrjedhë uji dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Shiko, në Finlandë ka shkolla me hokej në akull, ka shkolla baleti në të njëjtën shkollë... Tash e dimë situatën tonë, të mos e çojmë më gjatë këtë debat, ju lutem!

Amendamenti 9, kush është... votoni. Votojmë tash! Edhe po vazhdojmë me votimin normal, se kështu me përralla...

Faleminderit! Kanë votuar 78 deputetë. Për 77, kundër 0, ka abstenuar 1.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Për? Abstenim? Një është kundër. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? 21 janë kundër. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? Janë 23 vota kundër. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? Një është kundër. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? Dy. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30, propozuar nga deputeti Rexhep Selimi me përkrahje të Komisionit Funksional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31. Me mbështetje të Komisionit Funksional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32, propozuar nga deputeti Imet Rrahmani me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33. Komisioni Funksional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 35.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 36.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 37.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 38.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 39.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 40.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 41. Janë dy propozime. Një është i Komisionit Funkcional - nën a; nën b është propozimi, ose amendamenti i deputetit Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Janë dy propozime, por në fakt është propozimi i njëjtë prej një deputeti. Amendamenti me përkrahje të komisionit është amendament i deputetit, veç i përgatitur më mirë teknikisht dhe i ka të qartësuar burimet. Prandaj, ne i ftojmë të gjithë deputetët, kur janë dy propozime që t'i tërheqin të vetat, sepse emrat në fillim ua kemi shkruar prej nga vjen ideja e projektit. Në të kundërtën, duhet të votohet kundër amendamentit të vet. Pra, ne duhet ta zgjedhim njërin prej tyre dhe rekomandojmë që të votohet rekomandimi i komisionit, sepse është më i përgatitur dhe i ka të qarta burimet e financimit.

KRYESUESI: Atëherë qenka me miratim të Komisionit Funkcional. Votojmë!

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 42. E kemi propozimin e Komisionit Funkcional dhe deputetin Islam Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Pacolli e ka kërkuar fjalën për sqarim.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ministrat, deputetë,

Kolegë të nderuar,

Medie,

Sigurisht që sot, pavarësisht që nuk e kemi arritur një përkrahje të mjaftueshme nga komisioni, unë jam shumë i lumtur se kemi filluar pas leximit të parë të Buxhetit për zgjerimin e një rruge, e cila me të vërtetë s'ka qenë dhe është shumë e nevojshme për qytetarin e Kosovës, e në veçanti të kësaj zone. Pra, zgjerimi i rrugës prej urës së Vetërnikut në drejtim deri në hyrje të Graçanicës, shpresoj në të ardhmen edhe më tutje.

Prandaj, unë i falënderoj shumë ministrat Pal Lekaj dhe Bedri Hamza, si dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, që më në fund e kemi gjetur një përkrahje të mirë. Megjithatë, unë nuk jam i lumtur që nuk është aprovuar e tërë shuma apo buxheti që është kërkuar për këtë rrugë për vitin 2018. Megjithatë, unë shpresoj që në shqyrtim të Buxhetit do ta gjejmë hapësirën dhe do ta kthejmë në atë që është kërkuar. Megjithatë, unë kisha dashur ta tërheq, që të mos dalim dy paralele. Të pajtohem me atë, sepse unë besoj se komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka parë hapësirën e mundshme. E falënderoj për këtë dhe shpresoj që edhe në të ardhmen, dhe unë mendoj që duke hequr këtë propozim, do të jetë në votim vetëm propozimi i komisionit dhe do të ndihem i lumtur se ky projekt është aprovuar dhe kjo do të shkojë përpara. Me komisionin do të kemi prapë punë, me ministrat po ashtu dhe do të shkojmë së bashku përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pacolli!

Atëherë votojmë amendamentin 42, zoti Pacolli u tërhoq nga propozimi i tij, kemi propozimin e Komisionit Funkcional.

Kundër, s'ka, abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48.

Propozuar nga deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58.

Propozuar nga deputetja Time Kadrijaj, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 60.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani, ju lus që të votojmë me kartelë, sepse kemi disa amendamente, të cilat janë të propozuara nga komisionet dhe nga deputetët.

I lus udhëheqësit e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët në sallë. Votimi do të bëhet elektronik.

Tani ia kaloj fjalën zonjës Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në legjislaturën e kaluar, kur kemi dërguar amendamente si komision, nëse është kryetari i Komisionit për Buxhet, zoti Lumir Abdixhiku, ndoshta është mirë të më dëgjojë.

Jemi ftuar si Komision për Legjislacion në Komisionin për Buxhet për t'i arsyetuar amendamentet tona dhe për këto amendamente si komision, po e them edhe një herë, nuk jemi ftuar të paktën për t'i arsyetuar para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe nuk është mirë që nuk jemi ftuar.

Amendamenti 61 ka të bëjë me Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas, ku si Komision për Legjislacion kemi kërkuar shumën totale prej 53 mijë eurosh, në kuadër të kategorisë “paga dhe mëditje” 22 mijë për katër zyrtarë të Agjencisë dhe në kuadër të kategorisë “mallra dhe shërbime”, 30 mijë e 820.

Pra, është e rëndësishme që ky amendament të përkrahet, madje unë i ftoj edhe deputetët e Kuvendit që ta përkrahin për faktin se Agjencia për Ndhimë Juridike Falas ka një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe sa i përket ndihmës që u ofron qytetarëve në nevojë. Ata qytetarë që s'kanë të hyra të mjaftueshme, që janë në ndihmë sociale, pikërisht është kjo agjenci që i ndihmon në raport me institucionet e drejtësisë apo për këshillat që kanë në raste të ndryshme.

Andaj, kjo agjenci ka borxh për avokatët që i ka angazhuar në rastet e ndihmave sociale dhe unë i ftoj deputetët e Kuvendin që ta përkrahin amendamentin 61. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Armend, a e ke kërkuar fjalën për këtë punë? Ku është Armendi?

Zoti Zemaj e ka fjalën për amendamentin 61.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Pajtohem plotësisht me kryetarin e Komisionit për Legjislacion pse duhet përkrahur ky amendament, ndoshta nuk është arritur të sqarohet edhe pozicioni dhe kërkesa e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, por është shumë e rëndësishme, sepse edhe veprimtaria e tyre është zgjeruar vitin e kaluar.

Veprimtaria e tyre nënkupton zyrat, të cilat ofrojnë shërbime juridike falas në territorin e Republikës së Kosovës nga e kaluara dhe domosdoshmërisht kërkon edhe staf shtesë dhe kuptohet cila është natyra, ata që e dinë se çka ofron Agjencia për Ndhimë Juridike Falas.

Nuk është çështja vetëm e kostos së pagesës së avokatëve, por është funksionalizimi i atyre zyrave që t'u përshtatet nevojave që janë emergjente dhe kategorive që i pranojnë këto shërbime.

Kështu që kjo më shumë ndoshta do të duhet të kishte një mirëkuptim nga ministri i Financave me ministrin e Drejtësisë dhe të shohin mënyrën e financimit apo gjetjen e burimit të financimit për këto arsye, të cilat i ka paraqitur edhe Komisioni për Legjislacion apo vetë Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Nëse këta kanë arsyeshmëri tjetër ose kanë qasje tjetër se si do të zgjidhet, atëherë mund të na i dhënë, por unë jam të përkrahur ky propozim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, e ke fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës i kemi trajtuar me kujdes kërkesat e njësisë buxhetore në kuadër të fushëveprimtarisë të komisionit dhe unanimisht i kemi përkrahur si të arsyeshme.

Kemi kërkuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa që t'i përfshijë, pse nuk i kanë përfshirë, nuk e di, gjithsesi unë personalisht do t'i votoj dhe i ftoj deputetët që t'i përkrahin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministria e Financave ka pasur dëgjime buxhetore me të gjitha organizatat buxhetore, sidomos sa u përket këtyre organizatave buxhetore, këtyre amendamenteve të propozuara prej Komisionit për Legjislacion, të gjitha organizatat buxhetore janë pajtuar në Ministrinë e Financave, kanë pasur rritje të buxhetit, është e drejtë e tyre, kanë shkuar në Komisionin për Legjislacion dhe kanë bërë kërkesa shtesë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa prapë i ka trajtuar të njëjtat kërkesa dhe prapë të njëjtat organizata janë pajtuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe mbi të gjitha amendamentet e propozuara prej Komisionit për Legjislacion nuk janë të kompletuara, sepse e japin vetëm shtesën, ndërsa nuk e tregojnë burimin e financimit.

Prandaj, i lus të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të gjitha amendamentet që janë në vijim, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të mos përkrahen, përndryshe nuk e kanë të propozuar se nga merren mjetet.

Nuk mund të japësh mjete e shtesa, nëse nuk e ke burimin e financimit.

Prandaj, ju kisha lutur që amendamentet që patën përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa kaluan, këto të tjerat në vijim asnjëra prej tyre nuk e ka përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk e ka burimin e financimit dhe nuk e ka kodin prej ku financohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër.

Për replikë, po besoj, është lajmëruar Albulena. Replikë me ministrin Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Amendamentet tona i kemi proceduar ashtu siç na është kërkuar nga stafi i Komisionit për Buxhet, pra me programe, me kode të programit e të tjera.

Arsyeja pse e përmenda faktin që s'jemi ftuar në Komision për Buxhet është pikërisht për faktin se në qoftë se ishim ftuar si komision, edhe do të mund të vendosnim bashkërisht se ku t'i marrim mjetet, sepse keni marrë mjete ku keni dashur, kudo, sepse ne i kemi të gjitha këto amendamente, disi është bërë ky buxheti i Kosovës si pazar, kush kujt po i përkrah propozime.

Prandaj, unë edhe një herë i ftoj deputetët që t'i përkrahin dhe nuk është e vërtetë kjo çfarë po thoni, zoti ministër, sepse edhe dje kam takuar përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial. Ata kanë kërkuar me ngulm që Kuvendi t'i përkrahë këto amendamente, por po ashtu edhe përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas. Disa herë i kemi dërguar kërkesa a qëndroni pas dhe nuk është e vërtetë që i keni marrë parasysh kërkesat e tyre buxhetore.

Janë shumë të mëdha kërkesat, është evidente, por të paktën kërkesat minimale është dashur të kihen parasysh.

KRYESUESI: Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë besoj që secili prej nesh kur diskutojmë, mund të themi mendimin, po ta themi mendimin pa i ofenduar të tjerët.

Është më se e vërtetë kjo që po them, në kohën kur i kemi zhvilluar dëgjimet buxhetore nuk kam qenë vetëm, po ka qenë në sallë numër i madh i njerëzve, kur e kanë kryer Komisionin për Buxhet dhe Financa, kanë qenë deputetët, ata i kanë paraqitur kërkesat e veta. Këto janë kërkesa, e nëse i marrim të gjitha kërkesat e organizatave buxhetore bëjnë 5 miliardë euro. Po flasim për kërkesa, ndoshta kanë mbetur edhe kërkesa të arsyeshme të papërfshira në buxhet, po brenda mundësive reale buxhetore, institucionet e drejtësisë kanë pasur prioritet dhe janë trajtuar. Nuk mund t'i japim më shumë as Prokurorisë, as Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kur s'i kanë

plotësuar pozitat të cilat i kanë. Le t'i plotësojë 690 pozita të reja ky sektor në raport me numrin aktual të pozitave që i ka, dhe pastaj flasim për pozita të reja.

Prandaj, unë besoj që organizatat buxhetore nuk e kanë thirrur Komisionin për Buxhet e Financa, nuk e ka thirrur Komisionin për Legjislacion, se Komisioni për Legjislacion nuk është organizatë buxhetore, po ka thirrur organizatën buxhetore dhe ajo i ka prezantuar kërkesat e veta para Komisionit për Buxhet e Financa. Ato që kanë qenë të arsyeshme Komisioni për Buxhet e Financa i ka marrë në konsideratë, ka reflektuar, ua ka siguruar burimin e financimit dhe janë prezente sot.

Të gjitha të tjerat nuk e kanë burimin e financimit dhe unë i lus deputetët që të njëjtat të mos i votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Arben Gashi, replikë!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj se çështja është shumë e thjeshtë, këto organizata buxhetore a kanë nevojë për buxhet a nuk kanë? Janë organizata buxhetore në sektorin e drejtësisë që është jashtëzakonisht i ndjeshëm.

Komisioni për Legjislacion, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet i ka analizuar dhe i ka konsideruar të arsyeshme, për këtë arsye i ka draftuar në formë të amendamenteve dhe i ka dorëzuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Është kompetencë dhe obligim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, bashkë me Ministrinë e Financave për ta parë a ka burime financimi. Nëse nuk ka burim financimi, këta zotërinjtë mund të thonë se janë të arsyeshme, po nuk ka para, po jo të thonë se nuk i plotësojnë kushtet ose janë të paarsyeshme.

Procedura është kjo, ne i kemi dorëzuar në komisionin përkatës dhe ky komision, së bashku me Ministrinë e Financave kanë për detyrë t'i gjejnë financat, nëse nuk ka, nuk ka, të thonë se nuk ka financa dhe kryhet kjo punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku, në emër të komisionit e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Më duhet ta ushtroj rolin e kryetarit të komisionit për hir të korrektësisë.

Përveç që kemi marrë amendamente prej Komisionit për Legjislacion, kemi marrë edhe kërkesa prej organizatave, në radhë të parë.

Pra, kemi zhvilluar takime me organizata dhe në këto takime pjesa më e madhe, edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, edhe Këshilli Prokurorial kanë dalë të kënaqura prej takimit.

Pra, ka procesverbal të takimit dhe mos harroni në komision kanë qenë të përfaqësuara të gjitha partitë politike, edhe të pozitës edhe të opozitës. Këto institucione kanë pasur rritje në buxhetin e 2018 diku 30% në pjesën më të madhe të buxhetit dhe jemi marrë vesh, jemi pajtuar me ta që në qoftë se ka nevojë për para dhe fonde shtesë, në plot arsye t'i amendamentojmë gjatë rishikimit buxhetor.

Pra, po e mirëkuptojmë kërkesën e Komisionit për Legjislacion, por Komisioni për Buxhet dhe Financa në këtë kohë nuk ka pasur mjete financiare për t'i përkrahur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha të them që shumica e këtyre amendamenteve që nuk e kanë mbështetjen e Komisionit Funkcional me siguri janë të arsyeshme, edhe unë jam i bindur që kishim mundur ne këtu për dy orë edhe 100 amendamente të tjera t'i bëjmë që janë të arsyeshme.

Po e tha edhe ministri, kërkesa totale e agjencive buxhetore është 5 miliardë, ndërsa buxheti është 2 miliardë, është e pamundshme të përfshihen të gjitha. Dhe, përkundër asaj që, për shembull, ka amendamente që i kisha votuar absolutisht me shumë kënaqësi, si amendamenti 83 e disa të tjerë, ju ftoj të gjithëve që të mos i votojmë amendamentet pa mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse vetëm sa do të shkaktojmë telashe në buxhetin final. Kjo vlen jo vetëm për deputetët e PDK-së, por është një ftesë për mirëkuptim që ta kalojmë buxhetin ashtu siç e ka sjellë me këto amendamente Komisioni Funkcional dhe të mos i komplikojmë gjërat më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, zoti kryesues,

Kolegë deputetë,

Edhe unë e mora fjalën për të bërë një sqarim, meqë jam anëtar i atij komisioni dhe pyetja e parë imja në komision ka qenë, sepse ne patëm ngarkuar një grup punues që të punojë me organizatat buxhetore dhe ata na i patën sjellë këto amendamente, në fakt këto kërkesa, të cilat i shndërruam pastaj në amendamente. Ku do t'i merrni paratë, nga cilat kode buxhetore do t'i marrim për t'ua dhënë këtyre, sepse tash unë nuk mund të premtoj votë këtu në komision, nëse nuk mund ta votoj në seancë plenare, më thanë jo nuk kemi kërkuar nga kode të tjera, nga vija të tjera, sepse ka rezerva, e thashë mirë. Nëse këto amendamente do të kërkohej në seancë që të votohen dhe paratë të merren nga rezervat, thashë do ta keni votën time.

Për hir të korrektësisë, votën në komision e kam dhënë me idenë që paratë do të merren nga rezervat, sepse e kam ditur që nëse miratohen këto amendamente, diku do të krijohet një disbalancë.

Pra, më duhet ta sqaroj, nuk po përmend emra të kolegëve se krijohet mundësia e replikës, pra njëzëri jemi marrë vesh që t'i mbështesim, por me idenë që paratë do të vijnë nga rezervat.

Pra, nëse ka rezerva, pse të mos mbështeten edhe më shumë institucionet e drejtësisë. Nëse nuk ka, nuk ka, prandaj më duhet të them që unë dua ta tërheq votën, të cilën e kam premtuar në komision, sepse nuk paska para në rezerva. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Për hir të korrektësisë më duhet të them se krejt çka ke thënë në komision është që kërkesat janë të arsyeshme, i dërgojmë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ata me siguri gjejnë hapësirën se ku i marrin këto para, të paktën për një pjesë të tyre.

Si duket, Komisioni për Buxhet dhe Financa edhe Ministria e Financave nuk i kanë gjetur. Unë mbes prapa qëndrimit tim se këto para janë të domosdoshme për ekzistimin e këtyre institucioneve, për rritjen e kapaciteteve të institucioneve në fushën e sundimit të ligjit.

Prandaj, unë personalisht do t'i përkrah dhe i ftoj deputetët e tjerë që t'i përkrahin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Desha ta bëj një sqarim këtu, flas si deputet dhe si zëvendëskryetar i Komisionit për Legjislacion.

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor i ka ftuar përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Agjencinë Kundër Korrupsion, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikimin e Pronës dhe Komisionin Qendror Zgjedhor. Të gjitha këto institucione bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion.

Ne pastaj kemi bërë edhe një grup punues nga komisioni, i cili i ka shqyrtuar kërkesat e këtyre agjencive, pastaj ka ardhur me rekomandime konkrete, në mbledhjen e komisionit të mbajtur më 12.12.2017 ne si komision kemi vendosur që t'i përkrahim kërkesat e agjencive, kemi bërë shtatë

amendamente, me të cilat i jemi drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe si komision, edhe në mbledhjen e fundit që kemi pasur, kemi vendosur që t'i përkrahim këto kërkesa.

Konsiderojmë që janë kërkesa të drejta, e kuptojmë plotësisht ministrin e Financave se është pamundësia buxhetore, por është mirë të shikojmë nëse jemi në arsyetimin e secilit amendament veç e veç, nga amendamenti 1 deri në amendamenti 7, të gjitha kanë një rëndësi të veçantë, sepse janë agjenci që bien direkt në fushën e drejtësisë, nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Akademia e Drejtësisë, Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, deri te Komisioni Qendror Zgjedhor, edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Në këtë rast ne kemi votuar në komision, nuk do ta tërheq voton, do t'i votoj këto amendamente, në të njëjtën kohë kërkoj nga kolegët deputetë t'i përkrahin këto amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari dua ta falënderoj shumë ministrin e Financave për punën me shumë kompetencë që e ka bërë, sidomos gjatë kohës së shqyrtimit të buxhetit në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe dua t'i falënderoj të gjithë deputetët, nga të gjitha subjektet politike, për punën me korrektësi, të cilën e kanë bërë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Dua të kërkoj nga të gjithë deputetët që të gjitha amendamentet, të cilat nuk janë përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, të mos votohen këtu.

Buxheti i ka disa specifika, të cila duhen të respektohen.

Ne i kemi shqyrtuar kërkesat e të gjitha këtyre agjencive. Nuk është vetëm ky vit që agjencitë e pavarura adresohen me kërkesa. Ne kuptojmë papunësinë, e cila mbizotëron në Kosovë dhe dëshira e secilit është të shtojnë nga 2-3 njerëz në punë, në mënyrë që mandej t'u ndahen mjete të caktuara për ata njerëz.

Unë i kuptoj edhe disa kërkesa të arsyeshme, të cilat i kanë pasur këto agjenci, të cilat për momentin nuk kanë pasur mundësi të plotësohen, por që nuk pengohet puna e tyre deri në rishikim të buxhetit. Për çfarëdo që do të ketë nevojë, me rishikim të buxhetit do t'i trajtojmë me kujdes.

Dua të them që buxheti nuk është pazar, as nuk është bërë asnjëherë me buxhet pazar, prandaj nuk është mirë të diskutohet në frymë të tillë, sepse në buxhet ka rregulla, ka procedura, të cilat duhet të plotësohen.

Kërkoj nga deputetët e Kuvendit që sa më shpejt t'i qasemi plotësim-ndryshimit të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Nuk është e arsyeshme që amendamentet të cilat nuk i plotësojnë kushtet për të qenë amendamente të figurojnë në raportin përfundimtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kërkoj nga deputetët që të marrim iniciativën për të bërë ndryshim-plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit që amendamentet, të cilat i plotësojnë kushtet të figurojnë si amendamente në raportin përfundimtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të gjitha ato amendamente, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për t'u trajtuar, të mos jenë pjesë e raportit dhe të krijojnë këtu hezitime.

Prandaj, unë kërkoj nga të gjithë deputetët që t'i votojmë të gjitha amendamentet të cilat janë të përkrahur nga komisioni.

Kërkoj nga të gjithë deputetët që t'i votojnë kundër të gjitha amendamentet, të cilat nuk janë përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse nuk janë të kompletuara, nuk i plotësojnë kushtet për t'u trajtuar dhe secili që ka arsye do të plotësohet në rishikimin e plotësim-ndryshimit, të cilat bëhen në qershor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, në fund do të flas për çështjen specifike. Po unë mendoj që problemi është i përgjithshëm.

Amendamente ka të drejtë të propozojë kushdo, po komisionet duhet të kenë parasysh arsyeshmërinë dhe ligjshmërinë, domethënë një amendament pa tjetër që duhet të jetë i arsyeshëm, po nuk mjafton, sepse duhet t'i plotësojë dhe kushtet ligjore dhe kjo duhet të vlerësohet së pari.

Unë besoj që një amendament i plotëson këto dy kushte, edhe kushtin e dytë, sepse më shumë po flasim për atë sot këtu, se çështja e arsyeshmërisë pastaj është çështje e argumentimit. Përpos që propozon buxhetin, duhet të propozojë dhe burimin. Unë mendoj që nuk mund t'i kërkohet Komisionit për Buxhet dhe Financa që të gjejë burimin pa e saktësuar se ku mund të merren. Këtë përvojë kam pasur edhe si anëtar i Qeverisë gjatë gjithë mandatit tjetër. Por, edhe një herë e theksoj që unë nuk po e diskutoj arsyeshmërinë, sepse s'e njoh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka kërkuar fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

E shfrytëzoj rastin, meqë e mora fjalën ta falënderoj ministrin e Financave, t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa për punën që jemi përpjekur ta bëjmë, një punë shumë profesionale dhe t'i kemi parasysh në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur dhe amendamentet, qoftë të deputetëve, qoftë të komisioneve parlamentare, qoftë të ministrive, apo të secilës organizatë buxhetore, veç e veç.

I kemi trajtuar në mënyrë profesionale dhe jemi munduar t'i mbështetim në të gjitha mundësitë të cilat i posedon ky projektbuxhet për vitin 2018. Ne bëjmë thirrje që të gjitha amendamentet, të cilat janë proceduar këtu pa përkrahjen të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, të mos përkrahen. I lus të gjithë deputetët për mirëkuptim. Shembull, një amendament që është nga Komisioni për Legjislativ thotë "kërkojmë mjete shtesë për trajnime dhe për gjëra tjera të prokurorëve dhe stafit tjetër". Me të vërtetë, edhe aty s'e kanë argumentuar aq shumë, po nuk po duam të hyjmë në atë, mendojmë që janë të rëndësishme, i kemi trajtuar, por nuk kemi arritur t'i gjejmë fondet. Prandaj, i ftoj deputetët që të mos e përkrahim asnjë amendament i cili është pa përkrahje të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Po e relaksoj pak debatin, kam përshtypje që janë dy probleme këtu: o nuk po duam t'i kuptojmë procedurat ligjore, që ne si deputetë e dimë që në rast se një amendament nuk kalon nëpër Komisionin për Buxhet, atëherë është absurditet të diskutojmë këtu, ose problemi i dytë është shumë prej neve s'guxojmë të flasim te shtëpia para grave e burrave, tani veç po shfryhemi këtu kot. Po flasim pa lidhje. Domethënë, unë s'jam duke kuptuar me të vërtetë çka jemi duke debatuar këtu. Ne "Nisma" kemi marrë vendim që të gjitha amendamentet, ja ku është Enver Hoti, ka qenë 5-6 amendamente, të cilat ne si grup parlamentar kemi marrë vendim t'i tërheqim. Gjithashtu, kemi thënë që nuk do të debatojmë për amendamentet, të cilat nuk kanë kaluar nëpërmjet Komisionit të Lumir Abdixhikut. Kaq! Kjo është shumë e thjeshtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë nuk ka tjerë të paraqitur. Diskutimet janë shteruar.

E votojmë me elektronikë amendamentin e 61, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tani!

Kanë votuar 79 deputetë, 23 janë për, 53 kundër, 3 abstenime. Nuk miratohet amendamenti 61.

Amendamenti 62, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ne thamë edhe më herët për amendamentet, të cilat janë propozuar nga Komisioni për Legjislacion konsiderojmë që janë amendamente të përpiluara mirë dhe i plotësojnë të gjitha kushtet formalo-juridike. Ajo është diçka tjetër, nëse janë mundësitë buxhetore është e pamundshme, është krejt diçka tjetër, por këto nëse i krahasojmë edhe me shumë amendamente tjera që kanë kaluar, janë shumë më mirë të përpiluara.

Është e nevojshme të përkrahet Akademia e Drejtësisë, me theks të veçantë në programin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar, i cili ofrohet për të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, si dhe pjesa praktike të trajnimit, e cila zhvillohet në gjykata apo prokurori, ku gjyqtarët dhe prokurorët kryejnë trajnime praktike nën mbështetjen e mentorit, i cili është gjyqtar apo prokuror dhe programi i mësimin në distancë, me qëllim që të ofrojë mundësi trajnimi me një metodologji dhe sistem mjaft të avancuar, që gjyqtarëve, prokurorëve, si dhe përfituesve të tjerë të identifikuar nga akademia, u mundëson ndjekjen e trajnimeve nga distanca.

Ne si komision, nëse doni arsyetoheni, nëse s'doni jo, kemi marrë t'i përkrahim. Unë kisha propozuar që amendamentet që i ka propozuar komisioni të hidhen në votim, dhe e kanë mbështetjen e Komisionit për Legjislacion, e në të njëjtën kohë kërkoj që të mbështeten edhe nga kolegët deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e votojmë amendamentin 62, me elektronikë. Votojmë tani!

Kanë votuar 77 deputetë, për janë 24, kundër 51, 2 abstenime. Nuk miratohet.

Amendamenti 63, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Për diskutim nuk është paraqitur askush. Votojmë me elektronikë!

Kanë votuar 63 deputetë, 12 janë për, 49 kundër dhe 2 abstenime. Nuk miratohet!

Amendamenti 64, Albulena Haxhiu është lajmëruar për të diskutuar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Amendamenti 64 ka të bëjë me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamentin e keni para vetes, por po e arsyetoj. Në projektbuxhetin aktual, pra për vitin 2018, i cili është miratuar edhe në parim në mbledhjen e kaluar të seancës plenare, janë përkrahur 148 pozitat e kërkuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Por, buxheti i aprovuar për ta mbuluar rekrutimin e këtyre pozitave është vetëm 421 979, që do të thotë që nevojiten edhe 1 milion e 285 mijë euro për t'i mbuluar pozitat që parashihen në këtë buxhet.

Pra, keni ndarë minus 1 milion më pak për pozitat, të cilat i keni lejuar. E unë kam pasur kontakte edhe dje me Këshillin Prokurorial të Kosovës, e kam edhe para vetes kërkesën me shkrim dhe edhe në këtë kërkesë Këshilli Prokurorial mbetet në këtë kërkesë që e ka deponuar edhe Komisioni për Legjislacion. Këtu hyjnë edhe shtesat e kujdestarive për prokurorë, andaj unë kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Republikës që ta përkrahim amendamentin numër 64. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e votojmë me elektronikë amendamentin 64. Votojmë tani!

Kanë votuar 72 deputetë, 40 janë kundër, 27 janë për, 5 abstenime. Nuk kalon!

Amendamenti 65. Votojmë tani!

Kanë votuar 72 deputetë, për janë 27, kundër 45, asnjë abstenim. Nuk miratohet!

Amendamenti 66, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tani!

Kanë votuar 80 deputetë, për janë 31, kundër 46, 3 abstenime. Nuk kalon!

Amendamenti 67. Votojmë tani!

Kanë votuar 65 deputetë. Për janë 13, kundër 49, kanë abstenuar 3. Nuk kalon!

Amendamenti 68, i propozuar nga deputeti Armend Zemaj, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Së pari, mendoj që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka bërë një punë të mirë, ndoshta edhe ky rifreskimi me deputetë të rinj ka dhënë edhe strategji të reja të futjes së amendamenteve, por që besoj janë në interes të qytetarëve të vendit.

Unë i kam paraqitur katër amendamente, zoti kryesues, kolegë deputetë, dhe anëtarët e komisionit kërkuar mirëkuptimin që ta tërheq një që ishte pak më i ekzagjeruar dhe që të më

pranohen tre, dhe pa dashur të përsëris, tri amendamentet tjera janë inkorporuar nëpërmjet pjesës tabelare të propozuara dhe të miratuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, e që ka të bëjë me tri projekte të rëndësishme: një në Junik, një në Lybeniq të Pejës dhe një në Raushiq. Ndërsa, amendamentin 68 unë e tërheq, po e tregoj arsien pse.

Sepse, rrugët e propozuara që kanë të bëjnë me nënprogramin për projektet e bashkëfinancimit me kuvendet komunale kanë qenë edhe në projektbuxhetin e viteve të kaluara. Janë të bartura. Nëse ka nevojë, unë po i përmend disa prej tyre dhe ajo çka është arritur është shtuar edhe një shumë buxhetore me propozimin e deputetes tjetër dhe është plotësuar ky amendament. Kështu që unë po e tërheq amendamentin 68, nuk po tregoj që ka qenë pjesë e strategjisë sime për të kaluar tre të tjerë dhe kjo pjesa tjetër, por edhe ky është pjesë e linjës buxhetore, kështu që i falënderoj për gatishmërinë dhe përkushtimin që kanë pasur që t'i renditim në kuadër të Buxhetit për vitin 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, s'ka nevojë ta votojmë, sepse zoti Zemaj e tërhoqi amendamentin.

Amendamenti 69, i propozuar nga deputetët Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj dhe Arben Gashi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky është një amendament që ne e propozojmë pothuajse secilin vit buxhetor. Kur kemi miratuar para disa vitesh Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, si LDK e kemi futur një nen, në të cilin thuhet që me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Ne jemi të vetëdijshëm që regjimi i atëhershëm serb nuk e ka njohur përvojën e punës, rrjedhimisht edhe stazhin e punëtorëve, sepse kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, të ndërtuar atëherë nga presidenti Rugova. Megjithatë, Kuvendi i Kosovës nuk do të duhej t'ua mohonte një të drejtë të tillë dhe, siç e dini, edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sa ishte e udhëhequr në atë kohë nga zoti Abrashi, e ka miratuar edhe rregullativën ligjore, por edhe urdhrin administrativ, në mënyrë që kjo të mund të implementohet, por punëtorët, qofshin ata të arsimit, apo edhe të kategorive të tjera, kur u njihet përvoja e punës në praktikë, nuk po u njihen edhe këto dhjetë vjet që kanë punuar.

Prandaj, në mënyrë që kur të kalkulohet buxheti për pensionistët kontributdhënës të mos mohohet edhe kjo përvojë e punës, ne kemi propozuar siç e thashë të njëjtin amendament, i cili

ka kaluar në buxhetet e viteve të kaluara, prandaj e propozojmë po të njëjtin edhe sivjet në mënyrë që Qeveria ta kryejë obligimin e vetë ligjor, të cilin e kanë marrë në bazë të nenit 8.6. të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Pra, thjesht, është një amendament që do t'ia mundësojë Qeverisë t'i kryejë obligimet e veta ligjore dhe t'ua njohë përvojën e punës këtyre punëtorëve, pra këtyre kategorive. Për shumë, zoti ministër, sepse po pyetni prej aty por nuk po dëgjoheni, besoj se mund të kalkulohet nga ju, sepse këtë kalkulim nuk mund ta bëjmë ne.

Prandaj, besoj që kjo ka qenë edhe arsyeja pse nuk është përkrahur nga Komisioni Funkcional, por unë po shpresoj shumë që deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë, në mënyrë që pastaj t'i hapet mundësia Ministrisë së Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ta përcaktojë shumën dhe në të njëjtën kohë t'ua njohë këtë të drejtë ligjore, po e përsëris, në përputhje me Ligjin për skemat pensionale punëtorëve të viteve '89-'99. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e votojmë amendamentin 69, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 88 deputetë, 40 janë për, 43 kundër, 5 abstenime. Nuk miratohet!

Amendamenti 70, i propozuar nga deputetja Besa Gaxherri, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zonja Gaxherri, e keni fjalën!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola këtu para jush të ju lus për vëmendje. Paraprakisht dua ta falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa për punën dhe përkushtimin e këtij komisioni, njëkohësisht edhe punën e ministrit të Financave me të cilin kemi bashkëpunuar. Mua personalisht, prej pesë amendamenteve, ky është amendamenti i cili jo vetëm që s'ka kaluar, por më ka zhgënjyer, për arsye se specifika e këtij amendamenti është ekskluzivisht e lidhur me gruan.

Ju kisha lutur për vëmendje dhe i kisha lutur të gjithë deputetët e pranishëm, njëkohësisht kisha pas qejf të jetë kryeministri tash këtu, edhe kryetari i Kuvendit, për arsye se sidomos këtë muaj që po e lëmë pas, secili nga zyrtarët e lartë, përfshirë Presidentin, Kryeministrin dhe Kryetarin e Kuvendit, kanë mbajtur konferenca për barazinë gjinore. Ndërsa, ky Kuvend e ka një grup të ashtuquajtur joformal të grave, e i cili është i themeluar në korrik të vitit 2005 nga mikja e Republikës së Kosovës, ish-sekretarja e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Medlin Allbrajt, e një pjesë e vogël e deputeteve këtu që jemi kemi qenë iniciatorë të themelimit të këtij grupi joformal.

Dhe, të nderuar kolegë deputetë, nga viti 2005 e deri më sot, ky grup joformal i grave funksionon pa kod buxhetor dhe pa asnjë cent. Ju lutem, ne jemi zyrtare të larta të shtetit, jemi deputete dhe ta keni parasysh që cilado OJQ e cila e ka një plan, një projekt të tyre dhe i ofrohet këtij grupi të deputeteve, ne ndonjëherë ndoshta duhet t'i përshtatemi atij projekti, e realisht nuk duhet të lëshohemi në çdo projekt që ofrohet. Paraprakisht dua të falënderoj NDI-në, që ekskluzivisht e ka financuar këtë grup joformal, por koha ka ardhur që ne ta kemi buxhetin për këtë grup joformal të grave ose, të nderuar kolegë deputetë, kolege në mënyrë të veçantë, në qoftë se sot nuk kalon ky amendament, kërkoj nga ju që ne të heqim dorë nga funksionimi i këtij grupi të deputeteve dhe ta shuajmë fare grupin joformal të grave.

Unë decidivisht po e lexoj amendamentin, sepse dikush mund të arsyetohet se është grup joformal, duhet të arsyetohet juridikisht dhe politikisht, dhe duhet t'i hapet një kod buxhetor. Pra, grupi joformal i deputeteve të Kuvendit të Kosovës është themeluar në korrik të vitit 2005, dhe ende nuk ka asnjë mbështetje buxhetore. Kërkoj që të krijohet një kod buxhetor dhe për këtë vit të ndahen 100 mijë euro për këtë qëllim. Mjetet, të cilat kërkoj të ndahen për këtë mund t'i marrim, zoti ministër, dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, pa dashur të bëj ironi, por për shembull në programin e stafit mbështetës politik të Kuvendit të Kosovës, që po i kërkojnë prej 46 staf politik të ndryshohen në 60, ndërsa stafin politik, pra tabelën 3/1000, 3.1. kategoria e shpenzimeve të pagave dhe mëditje rritet prej 600 mijë euro në shumën 856 mijë euro, njëkohësisht stafi mbështetës politik, prapë kategoria e shpenzimeve dhe mallrave dhe shërbime, shuma prej 90 mijë shkon në shumën 130 mijë euro, ndërsa ne e kemi kërkuar vetëm 100 mijë euro. Dhe, të mos flas edhe për vendimin, mirë bëre kryeministër që erdhe, dhe uroj të më kesh dëgjuar, dhe pres prej teje, pres edhe prej kryetarit të Kuvendit, që s'qenka, pres që ta aprovoni ju, të kërkonin edhe ju nga deputetet dhe deputetët ta aprovojnë këtë amendament, sepse vërtet është jobarazi gjinore dhe në qoftë se deputetet..., Ju kisha lutur për vëmendje, për një minutë qetësi!

Në qoftë se ne jemi shembull konkret se si ndahet buxheti gjinor te vetë deputetet dhe grupi joformal i deputeteve këtu, atëherë nuk ka koment. Prandaj, unë kërkoj, në qoftë se nuk do të aprovohet ky amendament, që ju gratë deputete në fund ta bojkotoni aprovimin edhe të krejt buxhetit. Pra, ta kushtëzojmë Qeverinë, në qoftë se kryeministri nuk do të thotë sot, me gjithë ministrin e Financave, që do ta aprovojnë këtë amendament. Dhe, unë kaq kam, e në qoftë ky amendament nuk do të kalojë, unë do të jem e zhgënjyer në radhë të parë nga vetë deputetet që janë këtu dhe kolegët e mi të gjinisë së kundërt deputetë, dhe njëkohësisht nga kryeministri dhe ministri i Financave. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë besoj që s'ka nevojë krejt gjinia femërore të diskutojë për këtë punë, besoj se mjaftueshëm e ka elaboruar propozuesja. Kështu që... Atëherë, po jua jap të gjithave, unë s'mund t'ua ndal fjalën. Zoti Bedri Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nëse është çështje kaq e rëndësishme dhe dua të besoj që punët mirë kryhen nga ky grup i deputeteve, megjithatë kemi pasur mundësi që këtë çështje ta adresojmë në mënyra tjera, por unë marr garanci që për të mos e prishur strukturën e Buxhetit dhe për të mos bërë precedent edhe për amendamentet e ardhshme, nga rezerva e Qeverisë, me vendim të Qeverisë, t'i ndahen 100 mijë euro Grupit të Grave Deputete.

KRYESUESI: Unë nuk e kam ndërmend të flas për këtë punë, por do të flisja me qejf. Fjalën e ka Shqipe Pantina, ose cila të doni... Shqipe, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në mandatin e kaluar, unë kam qenë anëtare e Bordit të Grupit të Grave Deputete dhe ne kemi diskutuar shpesh se si ky grup duhet të punojë që t'u realizohen të drejtat grave të tjera, grave të qytetarëve të këtij vendi, të drejta të cilat shkelen në vazhdimësi, por qëllimi i Grupit të Grave Deputete nuk është për të punuar për vete, për ne si deputete, për të punuar për t'u arritur barazia gjinore në nivel vendi. Pra, roli ynë është për t'i mbrojtur, për t'i avancuar, për t'i çuar përpara të drejtat e secilës grua në Republikën e Kosovës, e të cilat për fat të keq vazhdojnë të shkelen.

Prandaj, unë me kënaqësi do të mbështesja një amendament, në këtë rast nga zonja Gaxherri, po të më shpjegonte se ku shkojnë, për çfarë na duhen këto para. Ne mund të luftojmë për të drejtat e grave duke kërkuar amendamente në Buxhet, por të cilat shkojnë për një arsim më të mirë, për shëndetësi më të mirë, për ujë, për kanalizim, probleme me të cilat në vazhdimësi ballafaqohen gratë në Republikën e Kosovës.

Por, nuk mund ta mbështes një amendament, i cili kërkon 100 mijë euro, e të cilat nuk e dimë për çka. Unë do të isha dakord po ashtu që të ndahej një kod buxhetor, që grupi i grave të funksionojë siç funksionojnë komisionet tjera, të cilat i kanë diku 5 000 euro në dispozicion. Unë gjithmonë kam qenë kundër dhe vazhdoj të jem kundër që, ta zëmë, kryetari i Kuvendit të ketë në dispozicion para për subvencion. Këtë e kam pas kundërshtuar edhe atëherë në Komisionin për Buxhet, edhe tani, por edhe këtë amendament, për fat të keq, unë nuk mund ta mbështes dhe nuk mund të kërkoj as mbështetjen e kolegëve të mi nga Lëvizja "Vetëvendosje", sepse nuk shpjegon mjaftueshëm se ku shkojnë këto para. Për çfarë duhen këto para?

Nëse ne duam të bëjmë projekte, duhet t'i drejtohem Qeverisë, që Qeveri të bëjë projekte që shkojnë në të mirën e grave dhe po ashtu të kërkojmë që ky Kuvend të miratojë ligje, të kërkojë zbatimin e tyre, që garantojnë barazi gjinore, por nuk mund të kërkojmë para për vete, për të funksionuar ne si grup. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa ka replikë me ministrin.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk kam replikë, por kam një falënderim për ministrin.

Në emër të gjithë deputetëve të pranishëm, që e akceptuan dhe do ta akceptojnë këtë amendament, por desha të kërkoj nga ministri që e theksoi se do të ndahet nga rezervat shtetërore, unë kërkoj ta kemi një kod buxhetor. Domethënë, ne duhet ta kemi kodin e veçantë buxhetore e pastaj... për shumën një. E dyta, me zonjën Pantina nuk do të merrem fare.

Më vjen shumë keq për diskutimin tuaj. Për shpenzimin e këtyre mjeteve do të vendosë Bordi dhe të gjitha gratë deputete të këtij Kuvendi të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Si ish-kryesuese e Grupit të Grave Deputete, natyrisht se e mbështes kërkesën e zonjës Gaxherri.

Ne gjithmonë kemi kërkuar që ky grup joformal të ketë një buxhet për aktivitetet, të cilat do të ndikojnë në barazinë gjinore, për t'i thyer barrierat e mëdha, me të cilat po përballen gratë në shoqërinë tonë dhe për të ndihmuar në lehtësimin e shumë çështjeve që prekin familjet tona.

E mbështes dhe e falënderoj po ashtu ministrin Hamza që vendosi ta ndajë këtë shumë për aktivitetin e Grupit të Grave Deputete. Meqë janë të gjitha partitë politike pjesë e Bordit, unë nuk e kam asnjë dilemë që mjetet e destinuar do të shërbejnë dhe do të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

KRYESUESI: Zoti Hamza s'i ka paratë e veta, duhet të votojnë deputetët njëherë, pastaj shohim. Kështu që falënderimet, pasi të votohet. Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë u entuziazmova kur e dëgjova zonjën Gaxherri që po kërkon buxhet për avancimin e pozitës së gruas. Dua të besoj se këto mjete po planifikohen për ta përmirësuar jetën e grave gjithandej në Republikën e Kosovës, e jo për shpenzime, të cilat do të mundësonin që ne që jemi deputete të kryejmë aktivitete të ndryshme.

Po sjell në vëmendje këtë se diku gjysma e popullsisë së Kosovës jeton sot me më pak se dy euro në ditë. Prej tyre, 29,3% sipas statistikave zyrtare jetojnë në kufirin e varfërisë, me 1,72 euro në ditë. Domethënë, gjendja është shumë e keqe dhe për më tepër, sipas raportit lidhur me varfërinë të Komisionit të Agjencisë së Statistikave dhe Bankës Botërore, varfëria vazhdon të mbetet më e theksuara në zonat rurale dhe sidomos në ato familje që udhëhiqen nga gratë. Pra, ato familje ku kryesojnë gratë janë në një gjendje të vështirë, gjë që ndikon pastaj edhe më tutje në një pabarazi shoqërore.

Mua më vjen mirë ta dëgjoj ministrin e Financave që ka mundësi të ndahet kaq buxhet për një propozim, i cili të paktën tani për tani nuk ka një projekt konkret, sepse po shpresoj se do të mbështesë edhe dy amendamentet që unë i kam paraqitur e që i konsideroj shumë të rëndësishëm.

Personalisht jam kundër këtij amendamenti, por megjithatë nëse kalon unë do të kërkoj më tutje që të bëhet një projekt i detajuar për të gjitha shpenzimet dhe aktivitetet dhe i njëjti të aprovohet paraprakisht nga Parlamenti, përpara se të destinohen mjetet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zëvendëskryetar!

Në lidhje me këtë amendament të deputetes Besa Gaxherri, dua të them se jam iniciatore e formimit të Grupit të Grave Deputete dhe natyra e këtij grupi ka shumë qëllime të larta, edhe politike, në rend të parë e ka avancimin e gruas në politikë, por dhe ngritjen e një dialogu të brendshëm ndërpartiak, e që duhet vlerësuar.

Tërë kohën, prej themelimit deri tani nuk ka pasur kod buxhetor dhe është punuar në baza vullnetare, dhe kjo nuk është e lehtë. Madje, edhe stafi, edhe pse i mbështetur nga NDI-ja, ose një organizatë tjetër jashtë Kuvendit, shpesh nuk është paguar fare. Kjo ka qenë shumë e vështirë për të punuar.

Sukseset e grupit të grave njihen, jo vetëm në Kosovë, por njihen edhe jashtë Kosovës, në regjion dhe shtetet tjera e kanë imituar formimin e grupeve të grave, për shembull, Maqedonia, Serbia, Shqipëria e tjera. Grupi i Grave Deputete e ka përfaqësuar vetveten si një shembull i mirë edhe në Uashington. Pra, është ndër sukseset e Parlamentit, por nuk ka pasur mundësi të përkrahet në baza materiale për asnjë send. Megjithatë, Kuvendi e ka pasur një mirëkuptim, duke përkrahur materialisht, domethënë me letër, me ndonjë makinë, ose ka ndarë zyrën, por këto nuk janë kushte të mira të punës. Megjithatë, ky grup parlamentar e ka një detyrë shumë më të madhe sesa e ka kryer deri më tani. Për këtë arsye mendoj që nëse i përmbahemi kësaj Rregulloreje të punës së Grupit Parlamentar Joformal të Grave Deputete, atëherë normalisht se nuk mund të punojë pa një buxhet, i cili do të ishte në kuadër të vetë udhëheqjes së Kryesisë së Parlamentit.

Në kuadër të komunave ekzistojnë grupet joformale të grave dhe kryetarët e shumë komunave, nëse jo të gjithë, ndajnë buxhet për aktivitete të veçanta të grave dhe për mbështetjen për kuadrot mbështetëse. Për shembull, sa jam unë e njoftuar, kjo shumë shkon prej dhjetë mijë eurove në vit. Sa do të harxhonte Grupi Parlamentar i Grave Deputete, unë, të them të drejtën, duke e ditur se është punuar tërë kohën pa mjete, nuk e di... Mua m'u duk pak numri i ekzagjeruar prej 100 mijë eurove, por sigurisht se kërkon mbështetje dhe përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Zoti kryesues, e tërhoqa fjalën. Kërkoj falje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në këtë situatë nuk ka nevojë që të diskutojmë për amendamentin, meqë Qeveria po e përkrah propozimin, deputetja duhet ta tërheqë amendamentin dhe Qeveria të vendosë për këtë shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryesues!

Unë qe sa po e kërkoj fjalën për...

Proceduralisht dhe ligjërisht, pasi ministri publikisht na premtoi që do të ndahet nga rezerva shtetërore kjo shumë, unë e tërheq amendamentin për të mos pasur më shumë diskutime. Faleminderit!

KRYESUESI: Dua veç të them se kjo s'ka asnjë bazë ligjore, as s'është e përputhur kurrkund me asnjë rregullorë të Kuvendit. Kurrë s'ka ndodhur që Grupin e Grave Deputete të mos e mbështesë Kryesia e Kuvendit për nevojat që i ka pasur dhe për kërkesat që i ka pasur.

Amendamenti 71, i propozuar nga deputetja Time Kadrijaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja Kadrijaj e keni fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Amendamenti 71 ka të bëjë me zgjerimin e qendrës së Deçanit nga Ura e Demës në Carrabreg. E falënderoj Komisionin për Buxhet që e ka përfshirë, prandaj e tërheq amendamentin. Njëkohësisht, nëse më lejohet e kam amendamentin 72, që është në radhë, e që është asfaltimi i rrugëve Strelc i Epërm, Dranoc, Gramaçel, Rostovicë, po ashtu është përfshirë në projektbuxhet diku në këto vijat buxhetore dhe e tërheq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Amendamenti 71 është tërhequr nga zonja Kadrijaj.

Amendamenti 72 është i ri, sërish i propozuar nga Time Kadrijaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. E tërhoqe edhe këtë? OK, edhe këtë e ka tërhequr.

Amendamenti 73, i propozuar nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja Lila, e keni fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Ky është një prej pesë amendamenteve që janë propozuar në Ligjin e Buxhetit, draft-ligjin 2018. Amendamenti 73 përfshin ndërtimin e kompleksit të fushave të tenisit në komunën e Gjakovës, projekt ky me kontratë të nënshkruar dhe me operator, i cili tashmë është duke punuar. Vlera totale e projektit ka qenë 488 mijë euro, përderisa me draftin e parë të buxhetit janë hequr këto mjete dhe janë lënë vetëm 100 mijë euro.

Unë propozoj që këtij projekti t'i shtohen të gjitha mjetet, pasi gjithashtu rrezikohen edhe Ministria e Kulturës dhe Komuna e Gjakovës që të paditen për arsye se kanë nënshkruar kontratë për të cilat nuk i kanë mjetet. Njëkohësisht, e falënderoj Komisionin për Buxhet e Financa që i ka marrë parasysh amendamentet për kthimin e mjeteve për ndërtimin, finalizimin, e qendrës kryesore të mjekësisë familjare, finalizimin, përkatësisht ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Korenicë, si dhe në kthimin e mjeteve për Shtëpinë e Kulturës në Rogovë të Hasit.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e votojmë me elektronikë amendamentin 73, të propozuar nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 65 deputetë, për janë 28 deputetë, kundër 32, kanë abstenuar 5 deputetë. Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 74, prapë i propozuar nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. E dëshironi fjalën, zonja Lila? Zonja Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Propozimi 74 në fakt ka të bëjë me një temë shumë të rrahur dhe të diskutuar. Ka tre vjet që me Bankën Evropiane për Rindërtim IBRD, Komuna e Gjakovës dhe Ministria e Infrastrukturës janë pajtuar në projektin, vlera e të cilit është 25 milionë euro në trevjeçar. Për këtë vit, Qeveria e Republikës së Kosovës, Qeveria Haradinaj, ka ndarë 3 milionë euro për qarkoren e Gjakovës, ndërsa me këtë rishikim të Buxhetit Ministria e Infrastrukturës ia heq edhe një milion euro dhe e zbrit nga 3 milionë në 2 milionë. Përderisa propozimi im ka të bëjë me kthimin e mjeteve në këtë projekt, përkatësisht projekti për ndërtimin e qarkores së Gjakovës, në vlerën fillestare prej 7 milionë euro, ndërsa mjetet të merren nga rruga Dollc-Gjakovë. Rruga Dollc-Gjakovë është rrugë e cila nuk e ka projektin, nuk e ka fizibilitetin dhe si e tillë ka mbetur në vlerën 4 900 mijë dhe, sipas të gjitha gjasave, do të jetë një prej projekteve për të cilat do të dëgjojmë shumë dhe me siguri as nuk do të arrijë të tenderohet për vitin 2018.

Andaj, propozoj që mjetet të kthehen në rrugën e qarkores së Gjakovës dhe të vazhdojë projekti ashtu siç ishte i planifikuar, me fizibilitet dhe me projekt detaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E hedh në votim amendamentin 74, i propozuar nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 69 deputetë, 33 vota janë për, 35 kundër, 1 abstenim. Nuk miratohet.

Amendamenti 75, i propozuar nga deputetja Mirjeta Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja Kalludra s'e ka kërkuar fjalën. A dëshironi të flisni? Shtypeni atë sustën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam kërkuar që të ndahen mjete për ndërtimin e rrugës transit në Klinë-Istog, respektivisht rruga nga N-9 deri tek R-104 Klinë-Gjurakoc. Kjo është kërkesë e gjithë qytetarëve të Klinës e të Istogut, e po ashtu edhe qytetarëve të tjerë që kalojnë nëpër këtë qytet, sepse siç e dini Klinë me ndërtimin e sheshit në qendër të qytetit nuk ka bërë zgjidhje për qytetarët pa e ndërtuar rrugën transit apo rrugët tjera, që ta kemi një qarkullim më të rregullt dhe më të lehtë për qytetarët, e jo ta kemi një bllokadë brenda qytetit.

Atëherë, në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimet e reja të rrugëve në Kodin e programit 205070, kodin e projektbuxhetit 15085 është planifikuar që për vitin 2018 të ndajë buxhet në vlerë prej 300 mijë eurosh. Mirëpo, unë mendoj se kjo shumë është shumë e vogël, sa për të thënë që s'kemi ndarë buxhet hiç. Andaj, duke e ditur se në çfarë gjendje po kalojnë qytetarët e komunës së Klinës, unë vlerësoj se është e domosdoshme kjo rrugë dhe propozoj, përkaëtisht kërkoj nga Ministria e Infrastrukturës për ndërtimet e reja të rrugëve, që me kodin e programit për vitin 2018 të ndahen mjete shtesë në vlerën prej 1 milion e 500 mijë eurosh për fillimin e ndërtimit të rrugës transit në Klinë, Klinë-Gjurakoc, kurse në planifikimin për buxhetin për vitin 2019 të planifikohen mjete shtesë në vlerë prej 800 mijë eurosh për përfundimin e ndërtimit të kësaj rruge.

KRYESUESI: Faleminderit! E votojmë amendamentin 75, i propozuar nga deputetja Mirjeta Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 70 deputetë, për janë 27 deputetë, kundër janë 40, 3 abstenojnë. Nuk miratohet amendamenti 75.

Amendamenti 76, i propozuar nga deputetja Mirjeta Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja Kalludra, dëshironi të flisni?

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I falënderoj kolegët deputetë, të cilët votuan për amendamentin që e kam propozuar, por prita nga deputetët e komunës së Istogut, të cilët e dinë se si është gjendja në qytetin e Klinës, sepse kalojnë andej, që ta votonin këtë amendament, këtë projekt që ka qenë shumë i rëndësishëm, si për komunën e Klinës, po ashtu edhe për atë të Istogut.

Tek amendamenti 76 është ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Klinë. Ne kërkojmë që për komunën e Klinës për vitin 2018 të ndahet buxhet shtesë në vlerë prej 500 mijë eurosh për ndërtimin e fazës së parë të ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. Kërkojmë që të ndahen mjete shtesë në kodin e programit 634660 1832364, kurse pjesa tjetër të mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me donatorët. Të ndahet pra buxhet për Komunën e Klinës apo për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila, edhe ashtu, në bashkëpunim me donatorët e ka planifikuar ndërtimin e disa impianteve nëpër disa komuna. Në këtë rast kërkojmë që të përfshihet edhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Klinës. Kërkoj që të votohet nga kolegët deputetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamentit 76, i propozuar nga deputetja Mirjeta Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 64 deputetë, për janë 24, kundër 34, kanë abstenuar 6 deputetë. Nuk miratohet amendamenti 76.

Amendamenti 77, i propozuar nga deputetja Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja Kalludra, e keni fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Tek amendamenti 77 është projekti për ndërtimin e shkollës fillore “Ismet Rraci” në komunën e Klinës. Për vitin 2018 janë ndarë mjete shtesë në vlerë prej 800 mijë eurove, prandaj unë kërkoj nga ministria të ndahen edhe 750 mijë euro, sa janë paraparë për vitin 2018, pra totali i mjeteve të ndahet për vitin 2018 të jetë 1 milion e 550 mijë. E kam bërë këtë kërkesë, ose këtë amendament, duke ditur se në shkollën “Ismet Rraci” mësimin vijojnë rreth 1 600 nxënës dhe gjendja në atë shkollë që është ndërtuar në vitin 1969 është shumë e vjetër dhe shumë dëmtuar, ambient jo i mirë për mbarëvajtje të mësimin.

Kërkoj, pra, që të ndahen, sepse çdo vonesë për ndërtimin e kësaj shkolle besoj se është e pajustificueshme, duke ditur se në këtë shkollë vijojnë mësimin 1600 nxënës, edhe objekti i ri përveç se do të ofrojë një ambient të sigurt, hapësirë të mjaftueshme, do të ketë edhe efekt të drejtpërdrejtë në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Desha të falënderoj edhe Komisionin për Buxhet, i cili e ka përkrahur, si dhe deputetët të cilët kanë votuar dy amendamentet e mia. Është fjala për amendamentet 33 dhe 37, është kërkuar ndërtimi i çerdhes në lagjen Arbëria në Klinë, i falënderoj shumë që kanë ndarë vlerën prej 250 mijë eurosh.

Edhe amendamentin 37 ka të bëjë me ndërtimin, në organizimin buxhetor Ministria e Infrastrukturës me kodin 205 bën ndryshimin, pra në përputhje me propozimet e mia, vlerën prej 300 mijë euro për projektin e asfaltimit të rrugës Përçevë-Sverkë-Klinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me votimin e amendamentit 77.
Nga deputetja Kalludra, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.
Votojmë tani!

Kanë votuar 68 deputetë, për 25, kundër 41 dhe 2 abstenime.
Nuk miratohet amendamenti 77.

Amendamenti 78, i propozuar nga deputeti Rasim Selmanaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Selmanaj e keni fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!
Amendamenti 78 nuk e ka marrë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, sigurisht në mungesë të mjeteve buxhetore.

Kam propozuar që për rrugën Deçan-Plavë, nga 2.4 milionë për vitin 2018, të ndahen 10 milionë, ose të paktën 5 milionë për vitin 2018.

Ndërsa, për vitin 2019 të ndahen mjete që të përfundojë ky projekt.

Unë kam marrë zotimin publik nga ministri që vitin e ardhshëm kompania e cila do të punojë në këtë rrugë do të përcillet me mjete buxhetore dhe po ashtu është një zotim publik që më 2019 të përfundojë ky projekt nacional, pra rruga Deçan-Plavë.

Kështu që duke besuar në këtë premtim publik të ministrit të Qeverisë, unë e tërheq amendamentin.

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Selmanaj e ka tërhequr amendamentin 78.

Amendamenti 79, i propozuar nga deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky amendament ka të bëjë me marrjen përsipër të obligimeve që dalin nga Kontrata kolektive e arsimit, gjegjësisht neni 35 të kësaj kontrate pika 8 dhe 9, të cilat kanë të bëjnë me pagesat e pagave jubilarë për mësimdhënësit që kanë 10 vjet, 20, 30 apo 40 vjet përvojë pune dhe tri pagave përcjellëse.

Për kujtesën tuaj, kjo kontratë është nënshkruar në prill të këtij viti, në mes të ministrit të Arsimit dhe kryetarit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe të dy palët janë pajtuar që zbatimi i Kontratës kolektive, gjegjësisht neni 35 të përfshihet në Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Unë në prezantimin e kisha parasysh dhe jam e vetëdijshme për arsyetimin që e dha ministri i Financave, zoti Hamza, që këto duhet të planifikohen nga Ministria e Arsimit dhe po ashtu nga komunat.

Mirëpo dua t'ju kujtoj se të gjitha rastet kur nuk paguhen, të gjithë personat, mësimdhënësit e pensionuar, të cilët kanë drejtuar kërkesë në gjykatë, të gjithë e kanë realizuar të drejtën e tyre. Pra, deri më tani komunat nuk i kanë marrë përsipër këto obligime, por palët i kanë nxjerrë nëpërmes gjykatës, që do të thotë vetëm se është një mundim, maltretim më tepër për mësimdhënësit e pensionuar dhe, në anën tjetër, ngarkon edhe më tepër buxhetin e komunave, gjegjësisht buxhetin e shtetit me pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

Kështu që, ju lus dhe ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë amendament, edhe për faktin se kjo është një kërkesë ligjore, të cilën janë të obliguara institucionet tona ta respektojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E votojmë amendamentin 79, i propozuar nga deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tani: Faleminderit!

Kanë votuar 66 deputetë, për janë 23, kundër 38 dhe 5 abstenime.

Nuk miratohet amendamenti 79.

Zonja Nagavci e ka edhe një amendament tjetër, 80, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Ky amendament ka të bëjë me planifikimin e buxhetit, gjegjësisht shtimit edhe të një nënprogrami të Ministria e Arsimit në fund të tabelës së kësaj organizate për pagesën e personelit profesional për të gjitha institucionet edukativo-arsimore të sistemit parauniversitar në Kosovë,

përkatësisht për pagesën e psikologëve, pedagogëve dhe asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Kemi menduar që fillimisht duhet të punësohen 100 psikologë apo pedagogë me pagën bruto prej 426 eurove, e që shuma e përgjithshme vjetore është 511 mijë e 200 euro dhe 50 asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta, me pagën bruto prej 380 eurove, që shuma vjetore e përgjithshme është 228 mijë euro.

Për kujtesën tuaj, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës e promovon sistemin jodiskriminues të arsimit, duke respektuar të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim si dhe mundësi të barabarta për arsimin cilësor dhe mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimin.

Duke pasur parasysh nevojën e madhe dhe po ashtu nenin 37 të këtij ligji që përcakton se personeli profesional jomësimdhënës, e po ashtu edhe neni 40 përparimet e arsimit gjithëpërfshirës, parashohin akomodimin e të gjithë fëmijëve pa dallim të kushteve fizike, individuale, sociale, gjuhësore apo të tjera, duke promovuar integrimin dhe duke ofruar mbështetje përkatëse realizuar në nevojat intelektuale të nxënësve.

Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe institucionet edukativo-arsimore të Kosovës vijojnë mësimin dhe arsimimin 6195 fëmijë me nevoja të veçanta dhe për pjesën dërmuese, të mos themi për gjithë ata, nuk është angazhuar personel kompetent.

Andaj punësimi i asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta është i domosdoshëm, ashtu sikurse është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe punësimi i psikologëve dhe pedagogëve dhe kjo besoj që është dukshëm e vërejtshme me situata që po ndodhin gjithandej në shkollat tona, ku ka një dhunë të madhe si në mes të bashkëmoshatarëve, e rastet e fundit edhe përdorim të dhunës të personave të rritur ndaj fëmijëve.

Kështu që e konsideroj shumë të rëndësishme, kostoja nuk është e madhe dhe ju lus, ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë amendament.

KRYESUESI: Faleminderit! Për amendamentin në fjalë e ka kërkuar fjalën zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti Haliti!

Meqë është edhe ministri këtu, kërkoj vëmendjen edhe të deputetëve të Kuvendit, amendamenti që ka propozuar zonja Nagavci është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Unë e them këtu para juve çfarë ka ndodhur gjatë këtyre ditëve që i lamë pas, sidomos në takimet që kemi pasur me nëna, me gra, situata është e tillë.

Nëpër shkollat fillore, nëpër kopshte fëmijët me nevoja të veçanta duhet ta kenë një asistent të tyre, që kujdeset vetëm për fëmijën me nevoja të veçanta.

Ka pasur raste të shumta ku nënat janë detyrua t'i largojnë fëmijët nga shkolla për shkak se nuk kanë pasur një asistent që kujdeset vetëm për fëmijën, domethënë është privuar një fëmijë me nevoja të veçanta nga shkolla pikërisht për faktin se s'ka pasur asistent.

Numri që ka propozuar Arbëria sigurisht që është i pamjaftueshëm, por është i domosdoshëm të paktën t'ia nisim me këtë numër, në mënyrë që disa shkolla t'i mbulojmë me 50 asistentë.

Zoti ministër, nëse e keni mundësinë, po ju lutem në emër të Grupit Parlamentar, fondin rezervë e përmendët më herët. Ju lutem, deklarohuni, sepse është tepër e rëndësishme që t'i kemi asistentët, t'i kemi pedagogët dhe psikologët nëpër shkolla, nëpër çerdhe, ashtu siç edhe e arsyetoi amendamentin zonja Nagavci.

Unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë votojmë amendamentin 80, të propozuar nga deputetja Arberie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

I kemi 72 vota, 34 janë për, 34 me kartelë janë kundër, një është pa kartelë kundër, ja ku e kam këtu, dhe bëjnë 35 vota kundër, 4 abstenime.

Nuk kalon.

Amendamenti 81, i propozuar nga deputeti Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Zharku, e keni fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë të nderuar.

KRYETARI: I lus deputetët të vijnë në sallë dhe të votojnë.

LUTFI ZHARKU: Së pari, nënkryetar, nuk di a është e mundur ta procedoj, kisha dashur që amendamenti të ndahet në dy pjesë që të votohet veç e veç, për shkak se janë dy projekte.

Projekti i parë ka të bëjë me vendimin e Komisionit ndërministror për t'i ndërtuar dy kycje të reja në autostradën "Arbër Xhaferi", një në Ferizaj dhe në Viti.

Kurse tjetri është kërkesë 10 milionë euro, për atë arsye kërkoja që të ndahet.

Kurse i dytë ka të bëjë me studimin e fizibilitetit për kalimin nëntokësor të hekurudhës nëpër Ferizaj, që është një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankën Investive Evropiane prej 300 mijë eurosh.

Unë do të doja që deputetët ta votojnë, të respektohet një vendim i Komisionit ndërministror dhe një marrëveshje që është kryer më herët me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në mënyrë që projekti të mund të shqyrtohet më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e votojmë amendamentin 81, të propozuar nga deputeti Lutfi Xharku, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Kanë votuar 66 deputetë, për janë 18, kundër 44 dhe kanë abstenuar 4 deputetë. Nuk miratohet amendamenti 81.

Amendamenti 82, i propozuar nga deputeti Nezir Çoçaj, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, zoti Çoçaj, e dëshironi fjalën?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë fillimisht dua të falënderoj ministritë përkatëse për ndarjen e buxhetit 350 mijë euro për rrugën që lidh të gjitha fshatrat e Hasit të komunës së Prizrenit dhe Gjakovës, 350 mijë euro për vitin 2018 dhe 150 mijë euro për vitin 2019.

Po ashtu ky amendament është numër 82, zoti nënkryetar i Kuvendit dhe ka të bëjë me Institutin Pedagogjik të Kosovës, gjegjësisht me rregullimin e statutit të rregullores së re të IPK-së që janë të harmonizuara me Ligjin për veprimtari kërkimore dhe shkencore, ku në të njëjtën kohë i gjithë stafi i Institutit Pedagogjik të Kosovës kalon nga ai që ka qenë deri më tani si shërbyes civil në staf personal dhe besoj se ka qenë mirë që edhe Ministria e Arsimit, gjegjësisht Ministria e Financave të ndajë 60 mijë euro që të bëhet kjo pagesë me qëllimin më të mirë të arritjes së cilësisë në arsim. E këta me të vërtetë të bëjnë kërkime dhe hulumtime profesionale shkencore që ta ndihmojnë edhe vetë Ministrinë e Arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 82, propozuar nga deputeti Nezir Çoçaj, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tani:

Pozita e keni humbur kuorumin, nuk ka kuorum votimi. Sa deputetë janë?

Memli, a po votojnë deputetët a jo, kanë harruar.

E përsëritim edhe një herë votimin.

Për amendamentin 82, i propozuar nga deputeti Çoçaj, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

60 deputetë kanë votuar, a s'po mund të qëndroni një gjysmë ore, e përsëris edhe një herë.

E përsëris edhe një herë amendamentin 82 të zotit Çoçaj. Votojmë tash!

Ju e dini që opozita nuk voton në momentin që ne nuk kemi kuorum, nuk ka nevojë ta përsërisim 100 herë.

Kanë votuar 64 deputetë, për janë 21 deputetë, kundër 41, një ka abstenuar.
Nuk kalon.

Amendamenti 83, i propozuar nga Blerta Deliu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Blerta, e do fjalën?

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Amendamenti im, ndonëse nuk e ka marrë përkrahjen e Komisionit për Buxhet, është amendament që parasheh rritjen e pagave për komunitetin artistik, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e kulturës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Tashmë Ministria e Kulturës ka hartuar një koncept-dokument dhe projekt-rregulloren për pagat dhe gradat e krijuesve dhe performuesve, si dhe punonjësve të trashëgimisë kulturore, e cila në koordinim me ministrin e di që do të dalë në Qeveri në muajin janar.

Mendoj që amendamenti im duhet të përkrahet, pavarësisht që nuk e ka marrë mbështetjen e anëtarëve të Komisionit për Buxhet, me që komuniteti artistik në Kosovë nuk ka turp të kërkojnë atë që u takon, sepse mendoj që ata kanë kualifikimin, përkushtimin dhe përgjegjësinë që u takon. Ata janë gjenerata e re e shtetit të ri, kanë vendosur të thyejnë heshtjen për realizimin e kërkesave të tyre, kërkesa të drejta dhe mendoj që ne si deputetë nuk duhet të heshtim dhe të rrimë kokë ulur karshi kërkesave të komunitetit artistik.

Ka pasur shumë deputetë, të cilët kanë dalë në grevën e komunitetit artistik dhe i kanë përkrahur kërkesat e tyre për rritje të pagave dhe kërkoj që t'i trajtojmë seriozisht dhe në mënyrë urgjente, pavarësisht se janë numër i vogël dhe mund të mos duken të rëndësishëm sa i përket përkthimit të tyre në vota.

Unë kërkoj edhe një herë mbështetjen e kolegëve deputetë.

KRYESUESI: Mendoj që zakonisht në këto raste zonja është për, në qoftë se ka dikush kundër të diskutojë, nga deputetët është mirë të diskutojë, në qoftë se është për, atëherë nuk ka nevojë.

Zonja Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Vetëm desha ta marr fjalën për shkak që u diskutua edhe brenda Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ministri e ka shpjeguar që në momentin që kryhet rregullorja, atëherë kjo veçse aprovohet, kështu që kisha dashur ndoshta edhe ministri ta konfirmojë këtë. Nëse është kështu, atëherë në rregull, parimisht e përkrah amendamentin. Faleminderit!

KRYESUESI: Kujtim, po do të flasësh?

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë besoj që është shumë e rëndësishme që për këtë çështje të deklarohen edhe përfaqësuesit e qeverisë, dy ministrat, edhe i Financave, edhe i ministri i Kulturës.

Unë mendoj që kjo është çështje shumë e rëndësishme, të gjithë punonjësit e këtyre sektorëve, krijues, performues dhe kërkues shkencorë, si të Institutit të Arkeologjisë, trajtohen ose si shërbyes civilë ose nëpërmjet Rregullores për krijuesit dhe performuesit të vitit 2011.

Ajo atëherë kishte dhënë një zgjidhje të përkohshme, besoj relativisht mirë, edhe rishikimi e zgjidh, po përkohësisht. Unë mendoj që kjo duhet të zgjidhet me ligj.

Ka pasur edhe protesta para pak kohësh dhe janë marrë detyrime karshi protestës dhe unë kërkoj që ato të adresohen.

Dhe, e dyta, me që po flasim për Rregulloren për krijuesit dhe performuesit, nëse ajo është pjesë e pakos legjislative për vitin 2018, Qeveria duhet ta ketë parasysh dhe duhet t'i japë zgjidhje kësaj çështjeje.

Nëse mbetet kështu dhe Qeveria nuk merr përsipër që ta zgjidhë, nëse mbetet si amendament, unë do të votoj për dhe u bëj ftesë edhe kolegëve të mi, së pari kolegëve nga Grupi Parlamentar i LDK-së që ta mbështesin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Po flasim ne ish-ministrat, e pastaj ndoshta fol edhe ministri. Mua më erdhi mirë që e dëgjova ish-ministrin, edhe pse gjatë krejt mandatit s'e ka trajtuar këtë çështje, nuk ua ka rritur pagat, përkundër premtimeve të vitpasvithshme dhe pajtohem që është kohë jashtëzakonisht e gjatë që nuk është rregulluar qëndrueshëm statusi i krijuesve, performuesve dhe i punëtorëve profesionistë, qoftë në institucionet e kulturës apo të trashëgimisë kulturore. Më vjen mirë që unë e kam sponsorizuar atë rregullore po përmendet sot dhe ka qenë një zgjidhje relativisht e mirë për një periudhë disavjeçare.

Pajtohem që si objektiv i fundit duhet të jetë rregullimi ligjor, por po ashtu mendoj që nuk është e drejtë as karshi artistëve sot që ne të bëjmë politikë, pavarësisht a prej PDK-së, a prej LDK-së, a prej cilësdo parti duke e ditur se pavarësisht prej protestës që u përmend, dy ministrat e Financës dhe i Kulturës kanë pasur komunikime edhe para se të ndodhë ajo me përfaqësues të Teatrit Kombëtar dhe u është bërë e qartë se nuk do të ketë zgjidhje vetëm për një grup prej 20-30 njerëzve, por duhet të ketë zgjidhje për krejt krijuesit dhe performuesit nëpër të gjitha institucionet. Do të bëhet, nëpërmjet ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores ekzistuese.

E tash nga ajo që është thënë edhe në këtë foltore të Kuvendit, në vitin 2018 do të bëhet plotësimi e ndryshimi i kësaj Rregulloreje dhe normalisht që Qeveria në momentin që e ndryshon, e merr përsipër edhe obligimin financiar dhe koston shtesë për rritjen, e cila do të vijë me plotësim-ndryshimin e saj.

Unë mendoj që sot, përkundër që po duket shumë pozitive edhe ky amendament dhe unë e përmenda këtë amendament në fjalën time pak më herët, pikërisht që e mbështes parimisht, po i kisha mbështetur parimisht edhe shumë amendamente të tjera, edhe këtë e thashë më herët, po sot ne s'mund ta prishim strukturën e buxhetit, në të cilin është punuar që sa muaj edhe prej komisionit, edhe prej Qeverisë dhe prej të gjithëve për të fituar poenë politikë për momentin.

Jam i bindur që do ta mbajnë fjalën Qeveria, ministri i Kulturës dhe i Financave. Unë personalisht, jo një herë, po nja pesë herë kam diskutuar me ta për këtë çështje dhe jam i bindur që zotimi i tyre do të realizohet nëpërmjet plotësim-ndryshimit të Rregullores ekzistuese, si një zgjidhje për fazën e ardhshme deri në miratimin e një ligji.

Andaj, mendoj që kjo zgjidhje e ka marrë rrugën e vet dhe nuk kemi nevojë ta komplikojmë me një amendament të sotëm, i cili nuk bën zgjidhje të qëndrueshme, por bën zgjidhje të pjesshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala, ka replikë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit! Unë prapë do të kërkoj që të deklarohen përfaqësuesit e Qeverisë, sidomos ministri i Kulturës që dhe të identifikohet si ministër dhe të dihet kush është, e para. E dyta, këto që po i thotë shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së janë të pavërteta, ndryshe shqip i thonë, edhe ka edhe terma tjerë, po unë s'i përdor.

Unë kam propozuar nenin 3 të Ligjit për pagat, të cilin e ka miratuar Qeveria dhe këto kategori i njeh si të veçanta. Pse ligji u tërhoq, është çështje tjetër. E dyta, në mars të këtij viti unë kam propozuar rritjen 50% të të gjithëve dhe propozimin e ka pasur dhe e ka trajtuar Ministria e Financave dhe pagat do të rriteshin nga shtatori i këtij viti, domethënë nga shtatori. E treta, Rregullorja nuk e zgjidh këtë çështje, e adreson përkohësisht, as ky amendament, po kjo është një mundësi, duhet t'i kthehemi ligjit dhe nëse e keni vërtet, respektojeni nenin që kam propozuar unë dhe që e ka miratuar Qeveria dhe kjo çështje do të zgjidhet sistematikisht. Dhe, e katërta, unë e çmoj shumë që kujdeseni dhe prisni që së pari të miratoni ligjet, por keni parasysh që rrogat për vete i rritët dhe s' pritet kurrfarë ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ke të drejtë. Më fal!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Po më vjen keq i nderuar nënkryetar i Kuvendit se the të pavërteta, e tani doli që kenë të vërteta. Ti po tregon çka ke dashur të bësh, unë thashë çka ke bërë, edhe thashë që realisht s'ke bërë kurrgjë, se s'ua ke rritur rrogat asnjëherë. Ashtu qysh i ke gjetur pagat që unë para teje i kam lënë, ti e ke përfunduar mandatin pa ua rritur asnjë cent. A ke pasur vullnet t'ua rritësh, të besoj, a e ke rritur, e the edhe vetë jo. Andaj, nuk është e pavërtetë, është e vërtetë. Por, unë shpresoj që ky Kujtimi i ri që rastis ta ketë emrin e njëjtë si ti, por ministri i ri, Gashi, jam i bindur që do t'ua rrisë pagat, edhe pse është në muajt e parë të mandatit të tij, e jo në përfundim të mandatit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kujtim Gashi, ministri i Kulturës e ka fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Faleminderit që po e përkrahni këtë amendament, por është e vërtetë që këto tri vjetët e fundit të gjithë krijuesit dhe performuesit janë zhgënjyer, sepse kanë pasur vetëm premtime dhe nuk kanë pasur lëvizje në këtë drejtim. Qysh ditët e para i kam takuar dhe të gjitha shoqatat sindikale e teatrin, qoftë artistë të tjerë janë të përfshirë në grupin punues që e kam themeluar për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, jemi në finalizimin e saj, do të kalojë në debat publik, e kthejmë në Qeveri, do ta miratojmë dhe të gjithë krijuesit dhe performuesit brenda buxhetit të Ministrisë së Kulturës do të kenë ngritje pagash për 50%, ashtu siç jemi dakorduar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Financave, zoti Bedri Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

U diskutua kjo çështje, mirëpo besoj që kjo është në rrugën e duhur për t'u adresuar përkohësisht nëpërmjet Rregullores, fondet janë brenda Ministrisë së Kulturës dhe janë të mjaftueshme, ndërsa zgjidhja përfundimtare definitive dhe rregullimi i shumë pabarazive brenda sektorit publik sa u përket pagave rregullohet me Ligjin e pagave dhe ligjet që e rregullojnë këtë lëmi.

Prandaj, për momentin, është çështja e adresuar dhe nuk është problem aspekti financiar për Ministrinë e Kulturës dhe këtë shpjegim e kam dhënë edhe në Ministrinë e Financave, edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe po e jap sot në seancën e Kuvendit. Do të thotë, nuk është problem lartësia e mjeteve financiare për adresimin e kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala, replikë!

KUJTIM SHALA: Edhe për njerëzit që janë gjatë këtu duhet shpjegime elementare. Ministrat nuk rrisin paga, pra duhet të keni parasysh, por Qeveria, e para. E dyta, nenin që e kam propozuar unë, ajo është zgjidhja, jo kjo, kjo është e përkohshme prapë vitin tjetër do të bisedojmë përafërsisht për këto. Ai nen, i cili ka përbrenda të gjitha interesat e atij komuniteti, duhet të mbetet te ligji dhe atë nen e kanë votuar të gjithë, edhe këta që po flasim sot.

Nuk mund të merren përsipër ato personalisht dhe, e dyta, nuk ka pasur nevojë të krijohet grup i ri punues për atë rregullore, sepse grupi ka qenë, edhe ata kanë punuar 7-8 muajt e fundit, kjo ka qenë marrëveshja. Dhe, e fundit, nuk është fjala vetëm për aktorë, ose për një kategori të krijuesve, por për të gjithë, në të gjitha institucionet publike dhe kjo zgjidhet vetëm me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka nevojë për diskutime të tjera, besoj.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamentit 83, propozuar nga deputetja Blerta Deliu-Kodra, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Kanë votuar 75 deputetë, për janë 36, kundër 37, 2 abstenime.

Nuk kalon!

Amendamenti 84, propozuar nga deputeti Hajdar Beqa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Beqa, e keni fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ne kemi pasur edhe dy amendamente të tjera, të cilat i kemi parë si kërkesë së bashku me deputeten Teuta Haxhiu, amendamenti numër 39 dhe numër 45, këto dy amendamente janë

përkrahur. Amendamenti 39 është përkrahur nga komisioni, edhe pse është projekt që vazhdon më 2018-2019, ku bëhet fjalë për rrugën Smolicë - Stubëll - Berjan- Nivokaz, e cila lidh dy komuna, komunën e Gjakovës edhe komunën e Junikut.

Për këtë amendament e falënderojmë komisionin dhe ministrin Hamza që ka gjetur mundësi ta futin në Ligjin për buxhet për vitin 2018. Në të njëjtën kohë kemi pasur edhe amendamentin 45, është një projekt i kamotshëm, i filluar në vitin 2009, për 28 fshatra të regjionit të Rekës së Keqe për ujë të pijes, edhe ky amendament është përkrahur pjesërisht nga komisioni, besoj që pjesa tjetër do të përkrahet me rishikimin e buxhetit, i cili do të ndodhë gjatë vitit 2018, edhe për këtë amendament e falënderojmë edhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, edhe ministrin e Financave që kanë gjetur hapësira, edhe pse ka pasur shumë vështirësi duke pasur parasysh mundësitë buxhetore.

Sa i përket amendamentit në fjalë, në këtë rast amendamenti 84, në dakordancë me ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, e bëjmë një tërheqje me kusht që ky amendament të përfshihet me rishikim të buxhetit të vitit 2018, edhe pse duhet ta kemi parasysh se është një amendament, nuk ka qenë ndonjë kërkesë e madhe, por është një amendament që ka të bëjë me asfaltimin e rrugës që lidh fshatin Botushë me shkollën e Molliqit në regjionin e Gjakovës dhe fshatin Molliq me shkollën, kryesisht është një projekt jo që kushton shumë, por është me rëndësi të veçantë sidomos për fëmijët e fshatit Botushë, të cilët shkojnë në shkollë, ku çdo ditë jeta e tyre është e rrezikuar nga rrëshqitjet e dheut, andaj unë në këtë rast e tërheq amendamentin, por në të njëjtën kohë zotohem që këtë amendament do ta procedojmë në koordinim edhe me ministrin e Infrastrukturës që në vitin 2018 ky projekt, në pjesën e dytë të vitit të përfundojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, zoti Beqa e ka tërhequr amendamentin 84. Unë ju kisha lutur që të mos zhvillohet debat për amendamente. Dy vetë le të diskutojnë, njëri për dhe në qoftë se ka dikush kundër, por kështu po shfrytëzohet për fushatë elektorale kush ka, kush s'ka.

Amendamenti 85, propozuar nga Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

“6+” është dakorduar me kryeministrin dhe ministrin e Financave që kjo kërkesë të shqyrtohet edhe të realizohet brenda Ministrisë së Arsimit, ashtu që besoj që MASHT-i do të shtypë libra e fletore prej klasës së parë deri në të pestën në gjuhën turke dhe në gjuhën boshnjake dhe të shpërndahen për nxënësit tonë, ashtu që ky amendament do të trajtohet brenda Ministrisë së Arsimit.

Do të flas për amendamentin 86 edhe 87. Prapë, këto dy amendamente do të trajtohen në Ministrinë e Kulturës, ashtu që si “6+” amendamentet 85, 86, 87 do t'i tërheqim. Edhe një

amendament, të cilin e kemi pasur në komision e kemi tërhequr, është për pedagogët edhe psikologët për komunitetin e turqve dhe boshnjakëve. Edhe për këtë e kemi marrë fjalën prej kryeministrit që do të realizohen brenda Ministrisë së Arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, “6+” i ka tërhequr amendamentet 85, 86 dhe 87. Vazhdojmë me amendamentin 88, propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ky amendament, për qartësim të të gjithë deputetëve, nuk kërkon mjete shtesë, është një praktikë që ne e kemi vendosur në Qeverinë paraprake në dy vjetët e fundit, për mjetet që ndahen nga disa institucione, ministri ose zyra, ta zëmë nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria për Kthim dhe Komunitete, nga Zyra e Kryeministrit tek Zyra për Çështje të Komuniteteve, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, tek subvencionet dhe transferet, këto të bëhen pas përgatitjes së një programi për ndihmë për komunitete, pasi ka pasur vazhdimisht ankesa nga komunitetet pakicë, jo serbë, që shpërndarja e mjeteve dhe shpenzimet janë më shumë në favor të një komuniteti të caktuar, prandaj ne patëm vendosur në buxhetet e kaluara që këto mjetet të ndahen nga Qeveria pas propozimit që vjen nga ministri përkatës, ose nga zyra përkatëse.

Pikat 8, 9 dhe 10, që kërkohet të shtohen në nenin 11 të projektligjit, është tek pjesa tekstuale, nuk kërkohen mjete shtesë. Unë besoj që i ndihmon Qeverisë në shpërndarjen më të drejtë të mjeteve për të gjitha komunitetet në Kosovë njësoj. I ftoj të gjithë deputetët që të përkrahin këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë për të diskutuar për këtë amendament. Atëherë, votojmë amendamentin 88, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 66 deputetë, për janë 17 deputetë, kundër janë 48 deputetë, një ka abstenuar.

Nuk miratohet amendamenti 88.

Amendamenti 89, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Ky amendament ka të bëjë me shumë çështje të informatave të plota që duhet të shpalosen në buxhet në tabelën një, për mënyrën se si mbulohet deficiti gjatë vitit. Është ndërruar tabela një e buxhetit, për herë të parë ka ndodhur kështu në buxhet. Ne me këtë amendament kërkojmë që kjo të kthehet, informatat që janë krejt në fund, te pjesa tekstuale e dokumentit të buxhetit që nuk shpallet në gazetën zyrtare, të bëhet pjesë e tabelës një, në mënyrë

që qytetarët, deputetët dhe të gjithë njerëzit e interesuar të dinë se si mbulohet deficitin buxhetor në baza të rregullta, përfshirë edhe financimin nëpërmjet huas brenda ose jashtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Votojmë amendamentin 89, të Grupit Parlamentar të LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Kanë votuar 66 deputetë, për janë 14 deputetë, kundër 53, asnjë abstenim.
Nuk miratohet amendamenti 89.

Amendamenti 90, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Më lejoni të jap vetëm një sqarim në buxhetin që është propozuar për sigurimet shëndetësore, ne e kemi të qartë që gjatë vitit 2018 nuk mund të fillojë projekti i shumëpritur për sigurimet shëndetësore në Kosovë. Prandaj, ky amendament krijon këtë bazë që eventualisht në pjesën e dytë të vitit të ketë mundësi të fillojë mbledhja e premieeve shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, e votojmë amendamentin 90, i propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tani!

Kanë votuar 71 deputetë. 19 janë për. 47 kundër. 5 abstenime.
Nuk miratohet amendamenti 90.

Amendamenti 91, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Hoti e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Amendamenti 91 ka të bëjë me përgatitjet e nevojshme që duhet t'i bëjë Forca e Sigurisë së Kosovës për t'u shndërruar në ushtri të rregullt. Unë çuditem se si Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është dakorduar që kjo të shkojë përpara. Është listë e pajisjeve nga ekspertë të fushës që kanë propozuar që të futen në buxhet gjatë vitit 2018 për t'u pajisur FSK që kurdo që krijohen kushtet e nevojshme për shndërrim të FSK-së në ushtri, ajo t'i ketë plotësuar standardet minimale teknike. Unë i ftoj deputetët që të reflektojnë dhe ta përkrahin këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Është e rregulluar kjo punë me rregulla të veçanta për numrin e sasisë, sa mund t'i kenë ata.

Amendamenti 91, votojmë tash!

Kanë votuar 67 deputetë, 25 janë për, 40 kundër. 2 abstenime.
Nuk miratohet!

Amendamenti 92, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Hoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Unë pak po mbetem i habitur, një çështje që është madhore, e rëndësisë nacionale, se si deputetët e marrin, të PDK-së në veçanti, të koalicionit qeverisës, e marrin me kaq neglizhencë. Amendamenti 92 është unaza e jashtme e Prishtinës, i nderuar kryesues, jeni duke kryesuar seancën, nëse doni të merrni fjalën dil këtu, ok, atëherë mos komentoni çfarë flasin deputetët.

Amendamenti 92 është unaza e jashtme e Prishtinës që është e planifikuar tash sa vjet, për shkak se Komuna e Prishtinës nuk ka mbërritur të çojë përpara këtë projekt, edhe për shkak të barrës financiare edhe kostos financiare të madhe që ka ky projekt. Unë ftoj deputetët që ta mbështesin këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Liburn Aliu e ka kërkuar fjalën.

LIBURN ALIU: Ky amendament është i ngjashëm me amendamentin që e kam propozuar, amendamenti 101 do të jetë, por unë e kam shtruar çështjen e shpronësimit në lidhje me unazën e jashtme. Konsideroj që ky amendament duhet të votohet, është projekt me rëndësi, duhet ta kemi parasysh një gjë për Qeverinë e Kosovës. Gjatë kohës sa kam qenë në Drejtorinë e Urbanizmit, kemi pasur kërkesa jashtëzakonisht të shumta nga Qeveria për ndërtimin e ndërtesave qeveritare. Nga universiteti ka sot në vazhdimësi kërkesa për ndërtime të objekteve, ku institucionet qendrore kërkojnë që këto ndërtesa të ndërtohen në qendër të Prishtinës. Nëse kishte për t'u realizuar unaza, atëherë do të kishim mundësinë që të gjitha këto ndërtesa të ndërtohen në Prishtinën e re, ku është kjo pjesa e unazës. Pra, është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe edhe për vetë Qeverinë.

Janë pronat në administrim të Qeverisë në atë zonë, me Plan rregullativ të Prishtinës së re parashihen për ndërtesa qeveritare dhe është jashtëzakonisht me rëndësi sikur të kishte për t'u ndërtuar kjo rrugë. Pra, është me rëndësi edhe për vetë Qeverinë. Unë mendoj që duhet ta mbështesim të mos e lëmë të mbërrijmë te amendamenti 101, po ta kryejmë tash.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, votojmë amendamentin 92, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kanë votuar 83 deputetë, 30 deputetë janë për, 50 kundër, 3 abstenime.
Nuk miratohet amendamenti 92.

Amendamenti 93, propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Unë këto ditë kam takuar edhe përfaqësuesit e pensionistëve, të Shoqatës së Pensionistëve dhe kemi analizuar bashkë me ta buxhetin për pensionet kontributdhënëse për tre vjetët e ardhshme 2018- 2020. Vlerësimi i tyre i argumentuar, por besoj që edhe ministri e ka parasysh dhe e ka bërë këtë analizë, është që buxheti i paraparë nuk e mbulon rritjen natyrore të pensionistëve kontributdhënës në tre vjetët e ardhshme. Prandaj, amendamenti që ne kemi propozuar është që të sigurohet buxheti që rritja natyrore e pensionistëve mund të mbulohet me buxhet të rregullt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Siç e thashë disa herë, pavarësisht që ka amendamente shumë të arsyeshme dhe që mund të jenë pozitive, mendoj që logjika e këtij amendamenti është absolutisht e gabuar. Sidomos kur ke parasysh që kërkesa është për ta bllokuar funksionimin e Ministrisë së Inovacioneve e Ndërmarrësisë, sepse kanë kërkuar që t'i shkurtohen fondet, edhe ashtu të vogla kësaj ministrie të re, që është në themelim, konsolidim e sipër. Andaj, mendoj që këtë amendament absolutisht në këtë formë që është ne duhet ta votojmë kundër dhe ta ruajmë Ministrinë e Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë si një ministri, e cila meriton që të ketë mbështetje edhe më shumë se kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Një sqarim, unë po besoj që po pajtohem për nevojën që të shtohet buxheti në këtë kategori. Tash burimi i mjeteve, ky është propozimi ynë, është çështje e ministrit të Financave dhe ne do të dakordohemi plotësisht nëse ky propozon ndonjë burim tjetër të mjeteve për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Kollçaku e ka kërkuar fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj! Edhe unë qëndroj pas asaj që e tha zoti Hoti, edhe pse është amendamenti i kërkuar dhe u tregua prej nga merren mjetet, ministri le ta gjejë mënyrën se si do t'ia bëjë e t'i rritë pensionet, se nuk mundet në Kosovë të bëhet fjalë e të fitohet poenë për rritje të pagave në fillim të vitit të ardhshëm, të cilat nuk do t'i përcjellim në të njëjtën kohë edhe me rritjen e pensioneve.

Ju e dini se si kategori gjithnjë është e lënë anash, të mos themi që moshë, ju e dini se vetëm 4% të popullatës mbi 65-vjeçarë i kemi në Kosovë. Ata nuk janë aq shumë. Çdo vit po vdesin, se jetëgjatësia e tyre është shumë e shkurtër në Republikën e Kosovës, fatkeqësisht, dhe këto kategori meritojnë që të përcillet çdo rritje e pagës me rritje të pensioneve. Nuk është e vështirë të gjenden këto pak mjete, përderisa me miliona euro po sigurohen vetëm për Kabinetin qeveritar dhe për zëvendësministrat. Prandaj, të mos vazhdojë kjo pabarazi sociale, por të kemi drejtësi, e sidomos për moshën e shtyrë, për të cilën vetëm fëmijët e tyre, fatkeqësisht, për momentin po mendojnë, sepse ata që s'kanë familjarë, ata nuk po mund të mbijetojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë e votojmë amendamentin 93, propozuar nga Grupi Parlamentar, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYESUESI: 87 deputetë kanë votuar, 33 për, 52 kundër, 2 abstenime. Nuk miratohet amendamenti 93.

Amendamenti 94, i propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Amendamenti 94 është thjesht zbatim i plotë i Ligjit për menaxhimin e financave publike sa i përket rregullit të pagave, pra rritja vjetore e pagave në përputhje me zhvillimin ekonomik në vend. Nëse i merrni projeksionet që vetë i keni bërë në Ligjin e Buxhetit në pjesën tekstuale analitike dhe nëse merret ajo përqindje, atëherë rritja e buxhetit për paga për vitet e ardhshme duhet të jetë ashtu siç është kërkuar në këtë amendament. Pra, është amendament që siguron zbatimin e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, jemi te amendamenti 94. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për ta votuar për amendamentin 94, i propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Faleminderit!

79 deputetë kanë votuar, 27 për, 52 kundër, asnjë abstenim. Nuk miratohet amendamenti 94.

Amendamenti 95, i propozuar nga deputeti Enver Hoti, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Hoti, e dëshironi fjalën apo...? Fjala për ju!

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I kam tri amendamente radhazi. Amendamentet nr. 95, 96 dhe 97 dhe unë do t'i tërheq këto amendamente, por njëkohësisht e shfrytëzoj rastin t'i falënderoj anëtarët e Komisionit për Buxhet, Kabinetin qeveritar për amendamentet e mëhershme që i kam pasur, amendamentet 20,

43, 44, 51 dhe 52, 57, të cilat kanë kaluar dhe mendoj se ne e kemi bërë një punë të mirë, sepse është kthyer një investim i ndalur për shumë vjet më herët. Unë vetëm dua të shpreh respektin për bashkëpunimin me ministrat e linjave. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e kemi tërheqjen e amendamenteve 95, 96 dhe 97 nga deputeti Enver Hoti.

Amendamenti 98, i propozuar nga deputeti Salih Salihu, por pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, zoti Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryetar!

Unë në këtë amendament kam kërkuar një shumë prej 500 eurosh për kyçjen e Vitisë në autostradën Prishtinë - Hani i Elezit. E kam paraqitur edhe në komision, mirëpo në komision nuk e mora përkrahjen për shkak se në njëfarë mënyre arsytimi m'u duk logjik, sepse nuk ka mundësi të ndahen mjete para se të arrihet një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë "Bechtel-Enka".

Në këtë rast, mbetet që ministri Pal Lekaj të merret me këtë çështje, që në ditët në vijim të vërë kontakt me "Bechtel-Enka" dhe të bëhet kjo punë. Ndërkaq, jam për ta tërhequr këtë amendament, pasi nuk ka mundësi të ndahen këto mjete, meqë s'ka marrëveshje. Por, ajo që më habiti është që ministri Zharku e kishte një amendament të ngjashëm dhe është për çudi se 3 vjet ka qenë ministër dhe 3 vjet s'ka arritur ta bëjë një marrëveshje me "Bechtel-Enka" që të kyçet komuna e Vitisë dhe një pjesë e Ferizajt në atë pikë. Ndërkaq tash bën amendament, kur e di ose e ka ditur që është dashur të ketë marrëveshje më herët dhe ka qenë ministër, ka qenë në pozitë dhe e ka pasur edhe kryeministrin. Por, tash ai nuk është këtu, shkoi, nuk priti fare së paku bile ta votojë këtë. Pra, unë këtë amendament po e tërheq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Salihu. Atëherë tërhiqet edhe amendamenti 98.

Amendamenti 99, i propozuar nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, Zoti Milosavljeviq apo zonja Bontiq. Zoti Milosavljeviq nga Lista serbe e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Srpske liste povlači amandman br. 99. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe amendamenti 99 tërhiqet nga Grupi Parlamentar i Listës serbe.

Jemi në amendamentin 100, i propozuar nga grupi i deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Rexhepi, fjala për ju, edhe zonja Emilija, janë lajmëruar të dy. Cili e merr fjalën? Apo... të dytë! Zoti Berisha, fjala për ju.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Zëvendëskryeministra,
Kryeministër,

Unë duke parë që ky amendament nuk e ka përkrahjen e komisionit dhe flet për një mekanizëm që është kushtetues, shumë i rëndësishëm, multietnik dhe shumë i rëndësishëm për proceset, nëpër të cilat kalon Kosova, sepse është një mekanizëm që vërtet mbron, nuk ka shumë kosto financiare, nuk ka projekte që realizon, por e ka një zë që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, e ky është Këshilli Konsultativ për Komunitete, që është në kuadër të Zyrës së Presidentit. Më vjen keq që për 46 mijë euro nuk ka gjetur përkrahje nga komisioni. Nuk e di sa ka arritur ta kuptojë vërtet rëndësinë e këtij këshilli, por mendoj se përderisa Zyrës së Kryeministrit për Komunitete i janë dhënë 500 mijë euro, ose Ministrisë për Kthim dhe Komunitete vlera marramendëse, atëherë mendoj se do të duhej të gjendej zgjidhje ose mundësi, që edhe Këshilli Konsultativ të përkrahej me 46 mijë euro, sepse vërtet këta kanë programe dhe kanë projekte që janë në terren.

Në anën tjetër, më vjen çudi pse kjo kërkesë nuk është e përfshirë në kuadër të amendamentit 12 të Zyrës së Presidentit, për shkak se ky mekanizëm është shumë i rëndësishëm në kuadër të Zyrës së Presidentit dhe nuk është paraparë që në kuadër të amendamentit 12 të parashihen kërkesa, ose të mbulohen. Propozoj që nga ministri të gjendet një zgjidhje, eventualisht nga Ministria për Kthim apo Zyra e Kryeministrit për Komunitete, sepse, tek e fundit, kemi të bëjmë me çështje që janë të komuniteteve dhe mendoj që duhet të mbulohet kjo fushë, sepse ka të bëjë me avokim, lobim dhe mbrojtje të të drejtave të komuniteteve dhe do të duhej të përkrahej, se nuk është vlerë e madhe dhe mendoj që duhet të hiqen 46 mijë euro dhe të kalojnë në këtë zyrë.

Mendoj që të gjitha komunitetet pajtohen për këtë fakt dhe nuk do të duhej që të bllokohet. Ministri mund të na japë zgjidhje dhe të na rekomandojë. Besoj që nuk na dëmtojnë 46 mijë euro nëse tërhiqen nga njëra prej linjave buxhetore, aq më tepër që është e propozuar Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe Zyra e Kryeministrit për Komunitete. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Berisha! Ministri i Financave e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti deputet,

Ne këtë e kemi trajtuar si kërkesë të arsyeshme dhe si të realizueshme, mirëpo ka mundësi të tjera ligjore që kjo kërkesë të përmbushet dhe është kërkesë e përmbushur. Prandaj, kjo ka qenë

arsyeja, e jo diçka tjetër, jo as për shkak të arsyeshmërisë, as për shkak të lartësisë së mjeteve, por kjo ka qenë arsyeja dhe është kërkesë që është e përmbushur nga Ministria e Financave. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Rexhepi e ka kërkuar fjalën dhe zonja Myfera Serbica-Shinik.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedniče.

Poštovani ministre,

I te kako je važno da podržite ovaj amandman koga smo podneli, jer je samo 46 hiljade evra i nije uključen u amandmanu 20 u budžetskoj organizaciji Kancelarije predsednika, koja iznosi više od 1 800 hiljade evra. Ako 46 hiljade evra je mnogo za Konsultativno veće za zajednice onda ne znam o čemu mi ovo govorimo a želim jasno vaše mišljenje po pitanju kako ćemo mi iz tog fonda dobiti ukoliko povučemo amandman? Molim vas, izjasnite se!

KRYETARI: Edhe një herë ministri dëshiron ta shpjegojë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Buxhet, ka të drejtë ligjore që nëpërmjet Qeverisë t’i destinojë mjetet në këtë kërkesë, prandaj nëpërmjet vendimit të Qeverisë do të plotësohet kjo kërkesë për këtë komunitet.

KRYETARI: E dëshironi fjalën, zonja Myfera dhe zoti Danush? Po, prapë zonja Myfera Serbica-Shinik e ka fjalën dhe Danush Ademi pastaj.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Teşekkür ederim sayın başkan,

Öncelikle Topluluklar Danışma Kurulu’nun bu talebini biz milletvekili olarak “6+” Parlamenter Grubu destekleyecektir. Ancak bundan beş yıl önce, aynı Topluluklar Danışma Kurulu dernek başkanları, milletvekillerinin orda olmamasını talep etmişlerdi, bu yasal hakkımız olmasına rağmen taleplerine karşılık biz gene de “6+” Parlamenter Grubu bu 46 bin euronun desteklenmesi yana oyumuzu kullanacağız. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Myfera, nënkryetare e Kuvendit! Danush Ademi, fjala për ju!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë e dëgjova dhe i përkrah kolegët. Kjo kërkesë ka ardhur dhe nuk e kemi parë të arsyeshme që ministria s’ka pasur mundësi t’i ndajë 46 mijë euro për Këshillin Konsultativ për Komunitete, meqë ai është i një rëndësie shumë të veçantë. Por, vetëm po na intereson, a është ana ligjore ato para që s’i ndahen, apo do të aplikojnë për çdo kërkesë ata në ministri që t’u ndahen në aspekt të veçantë këtij këshilli.

KRYETARI: Zonja Duda Balje, urdhëro!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Još jednom u ime grupe, ministre, ja vam se zahvaljujem što ste odobrili zahtev Konsultativnog veća. Verovatno ste i vi kao i mi svesni da je to veće jako značajno za nas zajednice. Još jednom vam se zahvaljujem u ime nas poslanika, i u ime članova Konsultativnog veća.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, amendamenti 100, i propozuar nga grupi i deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

75 deputetë... Urdhëroni, a ka probleme? Votimi u krye. Ka përfunduar votimi, të lutem! Urdhëro, zonja Duda Balje, Emilija Rexhepi. Urdhëroni, edhe një herë!

DUDA BALJE: Ja ne vidim razlog zbog čega bi glasali kad smo dobili potvrdu od ministra da će to da prođe. Mislim da glasanje nema efekta uopšte.

KRYETARI: Zonja Emilija, e dëshironi fjalën?

EMILIJA REDŽEPI: Gospodine predsedniče!

Ministar je rekao kako ćemo to odraditi, tako da nema potrebe proces glasanja.

KRYETARI: A po e tërhiqni, se edhe ashtu nuk ka kaluar, edhe pse është... Nuk ka kaluar, ta kini parasysh! Edhe në këtë votim s'ka kaluar, po a po dëshironi ta tërhiqni pa e futur në votim, apo e dëshironi këtë rezultat? Urdhëro, Veton!

VETON BERISHA: Po, kryetar!

Meqenëse unë e fillova fjalën për këtë pikë, atëherë meqenëse morëm zotimin dhe ka procedurë dhe është ligjore, e tërheqim propozimin dhe shpresojmë dhe besojmë që ky të implementohet, kërkesa të jetë e implementueshme. Pra, e tërheqim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për amendamentin 100 anulohet votimi, për arsye se tërhiqet nga vetë propozuesi.

Jemi në amendamentin e fundit, të propozuar nga deputeti Liburn Aliu, amendamenti 101, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Urdhëro, zoti Aliu!

LIBURN ALIU: Amendamenti im ka të bëjë me unazën e qytetit të Prishtinës, respektivisht për fillimin e projektit të shpronësimit, pra para se të fillojë realizimi. Është i ngjashëm me amendamentin që ishte më herët, por aty flitej vetëm për ndërtimin e rrugës, ndërsa amendamenti im ka të bëjë me shpronësimin dhe unë kërkoj mbështetjen e deputetëve që projekti i unazës së

Prishtinës të fillojë. Është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sidomos edhe për vetë Qeverinë dhe për ndërtesat qeveritare.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër i Financave, fjala për ju!

MINISTRI BEDRI HAMZA: E kemi diskutuar këtë amendament në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ka qenë thuajse një konsensus i përgjithshëm për rëndësinë e këtij projekti. Sa u përket procedurave të shpronësimit, ekziston fondi brenda Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili nuk është i specifikuar se për cilin projekt kryhet shpronësimi dhe nga aty mund të përdoret për projekte që janë në proces. Ndërsa sa i përket projektit si tërësi, ne jemi pajtuar që pas studimit të fizibilitetit, pas plotësimit të kushteve, në proceset e ardhshme buxhetore të trajtohet dhe brenda mundësive reale, duke pasur për bazë rëndësinë e këtij projekti, të jetë pjesë e Buxhetit të Kosovës, do të thotë i financuar nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës.

KRYETARI: Faleminderit! Propozues, e tërheq apo e vazhdojmë në votim? Urdhëro, Liburn Aliu, edhe një herë!

LIBURN ALIU: Meqenëse paska fonde, zotimi m'u duk paksa i mjegullt, nuk e kuptova nëse do të fillojë çështja e shpronësimit, se unë e kam të qartë që realizimi i projektit nuk mund të bëhet njëherë pa u bërë shpronësimet, kjo e para. E dyta, fizibilitetet dhe analizat janë kryer, aty madje ka edhe projekt të detajuar për atë projekt. E ka kryer projektin dhe e ka mbështetur edhe ministria financimin e projektit, të cilin e ka realizuar Komuna në vitin 2009, po flas për dizajnin teknik. Tash është vetëm çështje e realizimit të projektit.

Pra, nëse zotimi që ju e thatë ka të bëjë vërtet me shpronësimin, fillimin e shpronësimit për këtë unazë, unë e tërheq amendamentin, por ajo që e thatë disi e la mundësinë që mbase edhe kjo nuk do të fillojë.

KRYETAI: Atëherë, amendamenti 101, i propozuar nga deputeti Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar, 4 abstenime, 29 për, 50 kundër. Nuk miratohet amendamenti 101.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në qoftë se ka mundësi le të bjerë zilja, deputetët që janë të gatshëm të votojnë le të kthehen në sallë.

96 deputetë janë aktualisht në sallën plenare. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 75 vota, 59 për, 16 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se ta mbyll seancën, në ndërkohë Kryesia e Kuvendit ka marrë një kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për ditën e sotme nga 43 deputetë. Ka të bëjë me lëndën Projektligji për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Kisha kërkuar që kolegët e Kryesisë menjëherë pas kësaj të dalim dhe ta mbajmë mbledhjen e Kryesisë.

Kolegë deputetë,

Kërkesa e 43 deputetëve është që sonte të mbahet seancë e jashtëzakonshme. A ka mundësi Kryesia në sallën 301? Po shkojmë menjëherë me shefat e grupeve parlamentare.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*